



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1274/7 prot.,

Datë 25.05.2026

V E N D I M
Nr. 699/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 25.05.2026 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “SAKULI” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedure e hapur e thjeshtuar”, me REF-79675-03-19-2026, me objekt: “Shërbime të printimit dhe publikimit, materiale promocionale”, me fond limit 2 793 950 (dy milion e shtatëqind e nëntëdhjetë e tremijë e nëntëqind e pesëdhjetë) Lek pa TVSH, zhvilluar në datën 07.04.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Korçë.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “FILARA” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedure e hapur e thjeshtuar”, me REF-79675-03-19-2026, me objekt: “Shërbime të printimit dhe publikimit, materiale promocionale”, me fond limit 2 793 950 (dy milion e shtatëqind e nëntëdhjetë e tremijë e nëntëqind e pesëdhjetë) Lek pa TVSH, zhvilluar në datën 07.04.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Korçë

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatorët ekonomikë “ALBDESIGN PSP” SHPK dhe “UNIVERS PROMOTIONS” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedure e hapur e thjeshtuar”, me REF-79675-03-19-2026, me objekt: “Shërbime të printimit dhe publikimit, materiale promocionale”, me fond limit 2 793 950 (dy milion e shtatëqind e nëntëdhjetë e tremijë e nëntëqind e pesëdhjetë)

Lek pa TVSH, zhvilluar në datën 07.04.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Korçë.

Ankimues: Operatori ekonomik “Inpress” SHPK, me Nipt. L52122014L dhe adresë Ish Blloku i Magazinave të Tregtisë, Rruga “Siri Kodra”, Tiranë

Operatori ekonomik “FILARA” SHPK me Nipt. K51611059N dhe adresë: Rruga Kavajes, Ish kombinati Misto Mame, Prane fabrikes Kaon, Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Korçë
Bulevardi Shën Gjergji, L.12, Korçë

Subjekte të Interesuara: Operatori ekonomik “ALBDESIGN PSP” SHPK me Nipt. L51819005Q dhe adresë: Rruga "Çerçiz Topulli", objekti Nr.17, Kashar, Tiranë

Operatori ekonomik “UNIVERS PROMOTIONS” SHPK me Nipt. K81324039M dhe adresë: Qafa e Kasharit, Mbikalimi i Rinasit, Kashar, Tiranë

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi Paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt - ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga 3 (tre) anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave, të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi, se ankesat janë për të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj ato duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.3. Operatorët ekonomik kanë prima facie interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.4. Operatorët ekonomik kanë paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar.

I.5. Ankimuesit kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik..

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 26.03.2026, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “Procedure e hapur e thjeshtuar”, me REF-79675-03-19-2026, me objekt: “Shërbime të printimit dhe publikimit, materiale promocionale”, me fond limit 2 793 950 (dy milion e shtatëqind e nëntëdhjetë e tremijë e nëntëqind e pesëdhjetë) Lek pa TVSH, zhvilluar në datën 07.04.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Korçë.

II.2. Në datën 07.04.2026 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Në datën 14.04.2026, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “FILARA” shpk	1.844.007 lekë	s’kualifikuar
2. “Inpress” SHPK	2.011.334,6 lekë	kualifikuar
3. “SAKULI” SHPK	1.891.240 lekë	kualifikuar
4. “ALBDESIGN PSP” SHPK	2.616.300 lekë	kualifikuar
5. “OPTIMA COMMUNICATION” SHPK	2.095.462,5 lekë	kualifikuar
6. Dhimitër Vasi	2.359.870 lekë	kualifikuar
7. “UNIVERS PROMOTIONS” SHPK	2.599.520 lekë	kualifikuar
8. “DIXHI PRINT - AL” SHPK	2.600.000 lekë	s’kualifikuar

II.4. Në datën 21.04.2026, autoriteti kontraktor ka publikuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik “Publikimi i Njoftimit të Fituesit Paraprak” për procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi.

II.5. Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe Autoritetit Kontraktor është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2026/6584 datë

24.04.2026 dhe me nr.1274 prot., datë 27.04.2026 e operatorit ekonomik "Inpress" SHPK, ku u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomikë "SAKULI" SHPK nga procedura e prokurimit të sipërcituar me pretendimin si më poshtë:

".....KVO e AK ka kualifikuar në mënyrë të gabuar OE Sakuli shpk., në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe nënligjore të fushës aktualisht në fuqi, si dhe në kundërshtim me kërkesat dhe kriteret e përcaktuara në DST e procedurës prokuruese objekt ankese, për arsytet e mëposhtme:

1.Së Pari, Së Pari, Operatori ekonomik "Sakuli" shpk., nuk ka paraqitur Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9 të DST, si dhe jo në përputhje me kërkesat e përcaktuara në pikën 2.1.a. "Kriteret e Veçanta të Kualifikimit", të shtojcës 8, të DST, në kundërshtim me: Nenin 76 "Kriteret detyruese për skualifikim" të ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik"; Nenin 77, pika 4 dhe 5 të Ligjit Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik";

. 2.Së Dyti, Ne kemi bindjen, që OE Sakuli shpk. do të duhet të skualifikohet në zbatim të Nenit 76, pika 3/h, të të ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, ku përcaktohet: "h. operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar nuk zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Kategoritë e profesioneve përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrisë përgjegjëse për punën.",...

...pasi, ky operator ekonomik nuk respekton dhe zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.

Për sa mësipër, i kërkojmë KSHA së AK Bashkia Korçë dhe Komisionit të Prokurimit Publik, që përpara se të marrë një vendim në lidhje me ankesën objekt shqyrtimi, të bëjë verifikime të mëtejshme dhe ti kërkojë me shkrim informacion zyrtar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Inspektoriatit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH), nëse OE Sakuli shpk. i respekton dhe zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë, apo jo...???

3.Së Treti, Operatori ekonomik Sakuli shpk. nuk disponon personelin teknik të nevojshëm për realizimin e shërbimit objekt prokurimi,.

Në pikën 2.2.2, të DST përcaktohet:

"Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë: Ofertuesi duhet te kete ne stafin e tij nje dizenjator, me eksperience te pakten 1 vjecare ne fushen e dizenjimit, te punesuar me kohe te plote dhe te perfshire ne listpagesa për muajin e fundit të deklaruar sipas legjislacionit në fuqi.

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

-Kontraten e punes

-CV

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 10 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, t? VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar "Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese, të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i" dhe "j", të pikës 2, të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto

dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

Ne kemi bindjen që Sakuli shpk. nuk disponon personelin teknik të nevojshëm ”Dizenjator”, i cili të figurojë në listëpagesat e muajit të fundit, referuar objektit të prokurimit, të kërkuar në DST.

Gjithashtu, ne kemi bindjen që OE Sakuli shpk. nuk ka paraqitur pranë AK dokumentacionin e nevojshëm ligjor “Kontratën e Punës + CV, me anë të së cilës provohet/vërtetohet disponimi i stafit

/ personelit teknik designer grafik të kërkuar në DST, si dhe “Eksperienca 1 vjecare” e kërkuar në DST.

Së fundi, do të donim të parashtronim, se stafi / personeli teknik designer grafik, i deklaruar nga OE Sakuli shpk., nuk është i regjistruar në listëpagesat e këtij operatori ekonomik, me kodet korresponduese përkatëse, sipas profesioneve të kërkuara në DST, objekt ankese, dhe në përputhje me kodet e Listës Kombëtare të Profesioneve (LKP), të miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 514, datë 20.09.2017 “Për miratimin e Listës Kombëtare të Profesioneve (LKP), të rishikuar.”

Rrjedhimisht, përsa i përket këtij kriteri teknik / profesional. bazuar në LPP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, si dhe në përputhje me kërkesat dhe kriteret e përcaktuara në DST, OE Sakuli shpk. do të duhet të skualifikohet.

4.Së Katërti, Në kundërshtim me pikën 2.2.4 “Aftësitë teknike dhe profesionale për makineritë”, të shtojcës 8, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit të DST.. Ne shprehim bindjen tonë, që OE Sakuli shpk. NUK disponon realisht 2 (dy) prej makinerive / pajisjeve të kërkuara në DST, dhe konkretisht: i. Makineri shtypi, ii. Pajisje laminuese.

Gjithashtu, ne kemi bindjen që OE Sakuli shpk. nuk ka paraqitur pranë AK dokumentacionin e nevojshëm ligjor dhe teknik, me anë të së cilës provohet/vërtetohet disponimi i makinerive / pajisjeve të kërkuar në DST, si dhe dokumentacioni plotësues teknik “foto per secilen nga pajisjet” i kërkuar në DST.

5.Së Pesti, Në kundërshtim me pikën 2.1.1. “Kapaciteti Teknik”, të shtojcës 7, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit të DST, ...Operatori ekonomik Sakuli shpk. nuk ka furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate, për secilin artikull / mall të kërkuar në DST.

Nisur nga njohja e mirë që OE Inpress shpk. ka në tregun shqiptar që përfshin edhe objektin e prokurimit konkret, dhe secilit prej mallrave / artikujve të kërkuar në DST, mendojmë që OE Sakuli shpk. nuk ploteson kriterin mësipër për punë / furnizime të mëparshme të ngjashme, pasi:

i.NUK ka paraqitur në sistemin SPE të APP punë / furnizime të ngjashme në total në vlerën 558,790 (pesëqind e pesëdhjetë e tetë mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë) lekë pa tvsh (20% të vlerës së fondit limit), dhe në proporcion me ofertën e parqitur prej tij për zërat e secilit prej artikujve / mallrave (20% të vlerës së fondit limit për secilin artikull / mall të ofertuar) të kërkuara në DST;

ii.NUK ka paraqitur në sistemin SPE të APP dokumentacionin ligjor dhe teknik të kërkuar nga DST dhe sipas përcaktimeve të specifikuara në DST, për të vërtetuar realizimin e punëve të ngjashme (në vlerën 558,790 (pesëqind e pesëdhjetë e tetë mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë) lekë pa tvsh), dhe në proporcion me ofertën e parqitur prej tij për artikujt / mallrat, e kërkuar në këtë procedurë prokuruese.

Duke iu referuar një për një, mallrave / artikujve të kërkuar në DST, si dhe specifikimeve teknike të përcaktuara në DST, kuptohet fare qartë se OE Sakuli shpk. nuk plotëson kriterin e përcaktuar në pikën 2.2.1. “Kapaciteti Teknik”, të shtojcës 8, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit të DST.

6.Së Gjashti, Në kundërshtim me kriteret e përcaktuara në DST, dhe rregullat e prokurimit publik, OE Sakuli shpk., ditën dhe orën e hapjes së ofertave, ka pasur detyrime tatimore të

papaguara dhe kontribute të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të papaguara. Për këtë arsye, kërkojmë nga KSHA e AK dhe KPP, që përpara marrjes së një vendimi të arsyetuar mbi këtë ankesë dhe përsa i përket kësaj pike, të kërkojnë zyrtarisht një informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

Gjithashtu, mendojmë që OE Sakuli shpk., nuk ka paraqitur / dorëzuar në sistemin SPE të APP, një Vërtetim të vlefshëm, i cili vërteton shlyerjen e të gjitha detyrimeve të faturave të energjisë elektrike, në të gjitha adresat ku ushtron aktivitetin ekonomik.

Rrjedhimisht, OE Sakuli shpk., do të duhet të skualifikohet pasi nuk plotëson kriteret e përcaktuara në DST dhe në rregullat e prokurimit publik.

** * **

Për të gjitha sa u parashtruan mësipër, KSHA e AK dhe Komisioni i Prokurimit Publik, pasi të kryejnë verifikimet e kërkuara të duhura, do të duhet të:

?Ndryshojë vendimin e marrë nga KVO e AK Bashkia Korçë;

?Skualifikojë OE Sakuli shpk.;

?...si dhe të shpallë fitues të procedurës së prokurimit të lartpërmendur, operatorin ekonomik “Inpress” shpk.....”

II.6. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesit, adresën dhe NUIS-et; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe formularin për publikim Nr. 1274/1 prot., datë 27.04.2026, me kriteret për të cilat operatori ekonomik “Inpress” SHPK pretendon se nuk përmbushen nga operatori ekonomik “SAKULI” SHPK, pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

II.7. Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik më datë 04.05.2026, protokolluar me tonën me shkresën nr. 1274/2 prot., datë 04.05.2026 është depozituar nga autoriteti kontraktor vendimi i Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave nr.4313/1 datë 04.05.2026 mbi trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “Inpress” SHPK, ku konstatohet, se autoriteti kontraktor ka vendosur mos pranimin e saj.

II.8. Me shkresën nr. 1274/3 prot., datë 12.05.2026, KPP ju drejtua autoritetit kontraktor për vënien në dispozicion të KPP të dokumentacionit të dorëzuar pranë autoritetit kontraktor nga operatori ekonomik “SAKULI” SHPK referuar nenit 26 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

II.9. Me shkresën me nr. 4911/1 prot., datë 14.05.2026 me lëndë “Dërgim dokumentacioni”, autoriteti kontraktor ka vënë në dispozicion dokumentacionin e dorëzuar nga operatori ekonomik “SAKULI” SHPK në autoritet kontraktor.

II.10. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e autoritetit kontraktor, u konstatua, se nuk ka pasur pretendime nga subjekte të tjera të interesuara, në përputhje me nenin 113 ligji Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik.

II.11. Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe Autoritetit Kontraktor është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2026/6591 datë 27.04.2026 dhe me nr.1294 prot., datë 28.04.2026 e operatorit ekonomik “FILARA” SHPK, ku u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “FILARA” SHPK dhe shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatorët ekonomikë “ALBDESIGN PSP” SHPK dhe “UNIVERS PROMOTIONS” SHPK me pretendimin si më poshtë:

“.....Së pari, kërkojmë të legjitimohemi për të paraqitur pretendimet tona për S'kualifikimin e ofertës së shoqërisë “ALBDESIGN PSP” shpk dhe për S'kualifikimin e shoqërisë “UNIVERS PROMOTIONS” shpk

Në këtë procedurë prokurimi kompania “FILARA” shpk ka INTERES TË LIGJSHËM dhe njëkohësisht është DËMTUAR nga veprimet e autoritetit kontraktor, për shkaqe që po i parashtrojmë më poshtë:

1- Kompania “FILARA” shpk ka ofertën më të ulët në këtë tender, duke qënë potencialisht pretendent për të fituar këtë tender.

2- Kompania “FILARA” nuk është skualifikuar për mosplotësim të kriterëve kualifikuese të përcaktuara në Shtojcën 7 të DST-ve, por për shkak se oferta jonë ekonomike ka rezultuar ANOMALISHT E ULËT.

Oferta Ekonomike e Shoqërisë sonë “FILARA” shpk është në kushtet e Ofertës Ekonomike e cila ka rezultuar si Anomalisht e ulët meqënëse rezulton , se vlera e saj është më e vogël se 85% e mesatares së shumatores së Ofertave të Vlefshme dhe si e tillë Oferta jonë është Konsideruar Automatikisht e Skualifikuar. Kjo Situatë ka ardhur si pasojë e kualifikimit të padrejtë të Operatoreve “ALBDESIGN PSP” shpk “UNIVERS PROMOTIONS” shpk

: Nga disa Verifikime mendojmë dhe kemi pretendime se Operatorët Ekonomikë “ALBDESIGN PSP” shpk “UNIVERS PROMOTIONS” shpk. nuk arrijnë të plotësojnë Kriteret e Përgjithshme të Kualifikimit, konkretisht të pikave:

a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit t? posaç?m n? rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);

c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;

ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;

d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale; dh nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;

e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;

gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Gjithashtu, ndër të tjera, nga ana e Operatoreve "ALBDESIGN PSP" shpk "UNIVERTS PROMOTIONS" shpk. sipas disa konstatimeve mendojmë se nuk janë respektuar mardhëniet e punësimit sipas legjislacionit në fuqi dhe në këto kushte të dy Operatorët Ekonomikë, nuk arrijnë të plotësojnë kushtet që kërkohen:

? Operatori ekonomik garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.

? Operatori ekonomik lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.

? Operatori ekonomik nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.

Në kuadër të verifikimit të përmbushjes së kriterëve të përgjithshme të kualifikimit, kërkojmë nga ana juaj një verifikim të plotë dhe të hollësishëm të dokumentacionit të paraqitur nëpërmjet formularit të vetëdeklarimit nga operatorët ekonomikë "ALBDESIGN PSP" shpk "UNIVERTS PROMOTIONS" shpk.. Ky kërkim bazohet në ekzistencën e indiceve të arsyeshme se, në momentin e plotësimit dhe paraqitjes së formularit të vetëdeklarimit, këta operatorë mund të kenë qenë në, në kundërshtim me deklaratimet të kriterëve të përgjithshme të kualifikimit.

Për të vijuar më tej, kemi pretendime se keto dy shoqëri nuk arrijnë të plotësojnë Kriteret e Vecanta për Kualifikim Konkretisht të pikave:

2.2 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.2.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes të njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së perlllogaritur të kontratës që prokurohet .

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

2.2.2 Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë:

a. Ofertuesi duhet te kete ne stafin e tij nje dizenjator, me eksperience te pakten 1 vjecare ne fushen e dizenjimit, te punesuar me kohe te plote dhe te perfshire ne listpagesa për muajin e fundit të deklaruara sipas legjislacionit në fuqi.

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

-Kontraten e punes

-CV

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 10 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, t? VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese, të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j”, të pikës 2, të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

2.2.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kësaj kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht 5 persona dokumentuar kjo me Vertetimin e pageses se sigurimeve shoqerore dhe shendetesore nga administrata tatimore dhe listpagesat e Kontributeve te Sigurimeve Shoqerore, Shendetesore dhe Tatimit mbi te Ardhurat nga Punesimi, për muajin e fundit të deklaruara sipas legjislacionit në fuqi.

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 10 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, t? VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “ Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese, të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j”, të pikës 2, të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

2.2.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

-Makineri shtypi

-Printer dixhital

-Pajisje laminuese

*Sqarim: Me pajisje laminuese nenkuptohet makineria per plastifikim ose makineria per ngjitje. Per pajisjet e mesiperme ofertuesi duhet te paraqese: foto per secilen nga pajisjet shoqeruar me dokumentacionin që vërteton pronësinë ose posedimin mbi pajisjet e mesiperme (psh. fatura blerje,deklaratë zhdoganimi, kontratë qeraje, kontratë dhurimi dhe cdo formë tjetër të parashikuar nga legjislacioni në fuqi për disponimin/posedimin e pasurive të luajtshme)

Përsa I përket pikës 2.2.1. të Kritereve të Vecanta për Kualifikim kemi bindje që këto dy Operatorë Ekonomikë, në lidhje me përvojën në realizimin e punëve të ngjashme, kemi indicie të arsyeshme dhe dyshime të bazuara se operatorët ekonomikë në fjalë nuk plotësojnë kërkesat specifike të përcaktuara në objektin e procedurës së prokurimit.

Nga informacionet dhe njohuritë që disponojmë mbi tregun përkatës të aktivitetit, na rezulton se këta operatorë nuk kanë realizuar punë të mëparshme të ngjashme, në përputhje me natyrën, kompleksitetin dhe kualifikimin e kërkuar në dokumentet e tenderit.

Në këto kushte, kërkojmë që të kryhet një verifikim i plotë dhe i detajuar i dokumentacionit të paraqitur për eksperiencë të ngjashme, si dhe i vërtetësisë së deklarimeve të bëra në këtë drejtim, në përputhje me kërkesat e dokumenteve standarde të procedurës.

Përsa I përket pikës 2.2.2. të Kriterëve të Vecanta për Kualifikim kemi bindje që këto dy Operatorë Ekonomikë megjithëse mund të disponojnë një Dizenjator nuk e kanë në përputhje me Kërkesat e Autoritetit Kontraktor pasi nuk zotërojnë Eksperiencë të pakten një Vjecare. Duke qënë se në fazën parapake të pjesamarrjes në tender Operatorët Ekonomikë e kanë plotësuar këtë Kriter me plotësimin e Formularit të Vetdeklarimit në përputhje me përcaktimet e nenit 26, pika 6, t? VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese, të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j”, të pikës 2, të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike, nëse këtyre Operatorëve mund ti kërkojnë një dokumentacion provues për disponimin

e Dizenjatorit sipas kushteve të përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor këta të fundit nuk mund ta provojnë këtë gjë pasi nuk e disponojnë sipas përcaktimeve.

Po ashtu, edhe përsa I përket numrit të punësuarve për muajin e fundit sipas përcaktimeve të pikës 2.2.3 , kemi bindjet tona se dy Operoret Ekonomikë nuk e plotësojnë këtë kriter pasi nuk kanë e disponojnë këtë numër punonjësish për muajin e fundit që korespondon me Shkurt 2026 dhe mbi të gjitha ende mendojmë se ende nuk ka shlyer detyrmeve e Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetsore përsa I përket muajit të fundit Shkurt 2026 përpara datës së Vetdeklarimit.

Ndër të tjera, gjithashtu kemi bindje se Operatorët Ekonomikë “ALBDESIGN PSP” shpk dhe “UNIVERS PROMOTIONS” shpk. nuk plotësojnë Kriteret e vendosura në pikën 2.2.4 Konkretisht të Printerit Dixhital dhe Makineri Plastifikimi. Printeri Dixhital është një makineri e kohëve të fundit dhe duke qënë në konkurim të vazhdueshëm në procedura të tjera prokurimi këto dy Operatorë shpesh here nuk kanë marr pjesë kur makineria “Printer Dixhital” ka qënë e përfshirë.

Përsa I përket Makinerisë “Paisje Laminuese” mendojmë se Operoret Ekonomikë kanë përfshirë jo makinerinë e duhur por makineri të cilat mund ta kryejnë shërbimin që kryen Objekt Prokurimi por duke qënë se janë makineri të cilat e kanë në funksionalitet dytësor këtë gjë, ky proces kërkon më tepër kohë gjë e cila do të silltë që ofrimi I shërbimit objekt prokurimi do të realizohej përtej afateve të përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor.

Pika e sipërcituar janë bindjet tona, të cilat ofertuesit I kanë reflektuar edhe në Ofertat e Larta të cilat janë në përfrimin e Fondit Limit, edhe pse mendojmë se kjo procedurë mund të kryehet edhe shumë më ulet se oferta ekonomike të paraqitur.

Këto vetdeklarime të cilat nuk janë në përputhje me Kërkesat e Autoritetit Kontraktor dhe Ofertat e tyre të mbiofertuar duke i krahasuar edhe me pjesmarrje në procedura të tjera prokurimi Publik kanë dëmtuar Ofertën tonë duke ngritur limit e 85% të shumatores së Ofertave të Vlefshme.

Për sa më sipër, kërkojmë nga Komisioni i Prokurimit Publik:

1. Verifikimin e Dokumentacionit Provues sipas Deklarimeve në Formularin e Vetdeklarimit për Operatorëve Ekonomikë “ALBDESIGN PSP” dhe “UNIVERTS PROMOTIONS” shpk dhe mbi të gjitha në përputhje me Kërkesat e Autoritetit Kontraktor, duke qënë se Kualifikimi i padrejtë i

njërit apo të dy Shoqërive ka sjellë që Oferta jonë Ekonomike të jetë në kushtet e Ofertës ANOMALISHT TË ULËT dhe si e tillë automatikisht është Skualifikuar....”

II.12. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesit, adresën dhe NUIS-et; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe formularin për publikim Nr. 1294/1 prot., datë 28.04.2026, me arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik “FILARA” SHPK si dhe me kriteret për të cilat operatori ekonomik “FILARA” SHPK pretendon se nuk përmbushen nga operatorët ekonomikë ALBDESIGN PSP” SHPK dhe “UNIVERS PROMOTIONS” SHPK, pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

II.13. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, u konstatua, se në përputhje me nenin 113 ligji Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik është depozituar Formulari i paraqitjes së Argumentave nga operatori ekonomik “UNIVERS PROMOTIONS” SHPK, protokolluar me tonën nr.1294/2, datë 04.05.2026.

II.14. Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik më datë 04.05.2026, protokolluar me tonën me shkresën nr. 1294/3 prot., datë 04.05.2026 është depozituar nga autoriteti kontraktor vendimi i Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave nr.4314/1 datë 04.05.2026 mbi trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “FILARA” SHPK, ku konstatohet, se autoriteti kontraktor ka vendosur mos pranimin e saj.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur saj si dhe informacionit e dokumentacionit të paraqitur nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Inpress” SHPK se:
“..Operatori ekonomik “Sakuli” shpk., nuk ka paraqitur Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9 të DST, si dhe jo në përputhje me kërkesat e përcaktuara në pikën 2.1.a. ”Kriteret e Veçanta të Kualifikimit“, të shtojcës 8, të DST.... Konkretisht, mendojmë se OE Sakuli shpk. ka përdorur tjetër formular vetëdeklarimi nga ai i publikuar nga autoriteti kontraktor në setin e dokumenteve standarde të procedurës së prokurimit objekt-ankimi. Mendojmë, se Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit i ngarkuar nga OE Sakuli shpk. në sistemin e prokurimeve elektronike ka ndryshime si në formë por dhe në përmbajtje që është më e rëndësishmja, dhe rrjedhimisht OE Sakuli shpk. nuk arrin të përmbushë kriteret e veçanta të kualifikimit, të përcaktuara në pikën 2.1.a. ”Kriteret e Veçanta të Kualifikimit“, të DST.....”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 10 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, të dokumenteve standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, , autoriteti kontraktor ka përcaktuar si vijon:

Shtojca 10.

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	----- --
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	----- -
E-mail:	----- -----

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se: <ul style="list-style-type: none"> Informacione për nënkontraktorin

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT -i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

- Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata											
<p>Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.</p> <p><i>Sqarimenëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>											
<p>Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>											
<p>Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th>Emri</th> <th>Mbiemri</th> <th>NID (Numri personal i identifikimit)</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> </tr> </tbody> </table>			Emri	Mbiemri	NID (Numri personal i identifikimit)						
Emri	Mbiemri	NID (Numri personal i identifikimit)									
<p>nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit</p>											

<p>të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.</p> <p>Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori Ekonomik nuk ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.</p> <p>Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përfunduar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>

Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

B: DEKLARATA “Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura”

Në cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, Deklaroj Se:

Jam në dijeni të pasojave që vinë ndaj meje lidhur me këtë Deklaratë, në respektim të ligjit nr. 9121/2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.

Kam përgatitur ofertën në mënyrë të pavarur, pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër¹.

Në veçanti, pa kufizuar si më lart, nuk kam pasur kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent me qëllim cënimin e konkurrencën, në lidhje me:

çmimet;
metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;
qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,
paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.

Nuk kam pasur marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent, me qëllim cënimin e konkurrencës, në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë.

Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t’u bëhen të njohura, me qëllim cënimin e konkurrencës, në çdo mënyrë qoftë, konkurrentëve të tjerë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj.

C: DEKLARATA “Mbi Konfliktin e Interesit”

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon: Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.

Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë:

- Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministrat, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të

¹ Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, fjala “konkurrentë” nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që: a) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor; b) është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.

Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtorit të Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

- Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kreut III, seksionit 2 të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, siç përcaktohet këtu të zbatohet vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe territorit të institucionit dhe juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varësie.

Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin ku zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafët 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin, d.m.th. **bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit dhe bashkëjetuesit.**

Unë jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcioneve Publike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimi dhe Kontrolli i Pasurive, si dhe Ligji Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik".

Në përputhje me to, unë deklaroj këtu se asnjë zyrtar publik, siç përcaktohet në Kapitullin III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk ka ndonjë interes privat, direkt ose indirekt, me personin juridik që unë përfaqësoj këtu.

D: DEKLARATA "Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës"

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Operatori ekonomik _____ garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.
- Operatori ekonomik _____ lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.
- Operatori ekonomik _____ nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit

A: DEKLARATË “Në përputhje me specifikimet teknike dhe grafikun e realizimit të objektit të kontratës”

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojnë të gjitha specifikimet teknike, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë (nëse kërkohet nga Autoriteti Kontraktor), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me Listën e mallrave dhe grafikun e lëvrimit të përcaktuar nga Autoriteti kontraktor.	Po [] Jo []

B: DEKLARATË

Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se: Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.	<u>Punonjës</u> Po [] Jo [] Nëse, po, numri i punonjësve: <hr/> Profili i punonjësve <hr/> <u>Makineri e mjete</u> Po [] Jo [] Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete: <hr/>
Emri, Mbiemri _____ Firma _____ Vula _____ Data e dorëzimit të deklaratës _____	

Ju lutemi sigurohuni që:

- Secili pjesëmarrës i renditur në një bashkim operatorësh ekonomikë të paraqesë një Formular të veçantë të Vetëdeklarimit.
- Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, një Formular i veçantë i Vetëdeklarimit duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

- Çdo vetdeklarim i pavërtetë/pasaktë nga ana e operatorëve ekonomikë jo vetëm që përbën shkak për skualifikimin nga procedura konkrete, por përbën shkak dhe për përjashtimin e tyre nga e drejta për të fituar kontrata publike deri në 3 vjet, sipas parashikimeve të ligjit për prokurimin publik.
- Operatorët ekonomikë që ofertojnë në procedurat e prokurimit të vetdeklarojnë në çdo rast informacionin e saktë që i korrespondon gjendjes së tyre faktike.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik për sa më sipër.

- Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike.
- Në procedurat e prokurimit me faza, ky dokumentacion i kërkohet të gjithë kandidatëve të kualifikuar në fazën e parë, përpara nisjes së afateve të ankimit.
- Ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, për dokumentat e ofertës të ngarkuara në Sistemin e Prokurimit Elektronik duhet të dorëzojë dokumentat provuese, të cilat duhet të jenë në origjinal ose në kopje të njehsuara. Ndërsa, dokumentet provuese, që do të paraqiten për të provuar vetëdeklarimet e bëra, duhet të paraqiten në origjinal ose të njësuar me origjinalin dhe të provojnë gjendjen faktike të ofertuesit në kohën e ofertimit të tij.
- Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

III.1.2. Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimeve elektronike si dokumentacionit të dorëzuar fizikisht pranë autoritetit kontraktor nga operatori ekonomik i kualifikuar i pari “SAKULI” SHPK, konstatohet se ky operator ekonomik ka dorëzuar:

- Shtojca 10 Formualri Përmbledhës Vetëdeklarimit i plotësuar në të gjitha fushat i firmosur dhe vulosur.

Shtojca 10.

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

Unë i nënshkruari Abedin Sakuli në cilësinë e administratorit të operatorit ekonomik Shoqëria “Sakuli” sh.p.k deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigja

Emri i operatorit ekonomik: (lu lutemi renditni të gjithë operatorit ekonomikë nëse jeni një BOE. lu lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE	Shoqëria "Sakuli" sh.p.k
Numri NIPT/et:	L11331015 S
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	Fshati Muçaj, Vore, Tirane
Përfaqësuesi (emri):	Abedin Sakuli
Telefoni:	0692062422
E-mail:	sales@sakuli.com

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Informacione për nënkontraktorin**

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT —i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

--	--	--	--

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJENE KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
<p>Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> Ekstrakt tregtar — Qendra Kombetare e Biznesit</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> Vertetim civil — Gjykata e Juridiksionit te Pergjithshem Tirane</p>
<p>Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:</p> <p>Abedin Sakuli — ortak dhe administrator etj.</p> <p>nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i></p>
Vertetim civil - Gjykata e Juridiksionit te Pergjithshem Tirane
<p>Operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> Vendim civil dhe penal — Gjykata e Juridiksionit te Pergjithshem Tirane</p>

<p>Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv). <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> Vertetim statusi aktiv — Drejtoria Rajonale e Tatimeve Tirane Vertetim falimenti dhe Vertetim likuidimi - Gjykata e Juridiksionit të Përgjithshëm Tirane</p>
<p>Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> Vertetim për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shendetesore - Drejtoria Rajonale e Tatimeve Tirane Vertetim për pagesën e taksave vendore — Bashkia Vore</p>
<p>Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> Vertetim debie — Operatori i OSHEE</p>
<p>Operatori Ekonomik nuk ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> Shoqëria “SAKULI” sh.p.k nuk ka asnjë rast të mëparshëm të mangësive apo vonese në realizimin e kontratave publike.</p>
<p>Operatori ekonomik ka regjistruar pronarit përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> Ekstrakt i regjistrit të pronarit përfitues — Qendra Kombëtare e Biznesit</p>
<p>Operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> Listepagesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shendetesore — Drejtoria Rajonale e Tatimeve Tirane</p>

Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.

Operaton ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenea përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Vertetim mosperjashtimi — Agjencia e Prokurimit Publik

Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Certifikata ISO9001:2015 — Certifikuar për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë (ICDQ)

Certifikata ISO14001:2015 — Certifikuar për Manaxhimin e Sigurisë dhe Shëndetit në Punë (ICDQ)

Certifikate ISO45001:2018 — Certifikuar për Sistemin e Menaxhimit Mjedisor (ICDQ)

B:DEKLARATA

Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura

Në cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, **Deklaroj Se:**

Jam në dijeni të pasojave që vinë ndaj meje lidhur me këtë Deklaratë, në respektim të ligjit nr. 9121/2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.

Kam përgatitur ofertën në mënyrë të pavarur, pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër’.

Në veçanti, pa kufizuar si më lart, nuk kam pasur kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent me qëllim cënimin e konkurrencën, në lidhje me:

çmimet;

metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;

qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,

paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.

Nuk kam pasur marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent, me qëllim cënimin e konkurrencës, në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë.

Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t’u bëhen të njohura, me qëllim eënimin e konkurrencës, në çdo mënyrë qoftë, konkurrentëve të tjerë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj.

’ Për qëllim të kësaj deklaratë dhe ofertës së paraqitur, fjala “konkurrentë” nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që: a) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor; b) është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.

C: DEKLARATA

Mbi Konfliktin e Interesit

Deklarata

Në cilësinë e operatorët ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon:
Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.

Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e **zyrtarëve** parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë **drejtpërdre**, indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë:

Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësmini Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të La Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarit e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarit e KG të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontro Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i **Bank** Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; en elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është barabartë me atë të Drejtorit i Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë e shërbimit civil.

Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarit sipas nenit 32 të kreut III, **seksi** të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, siç përcak këtu të zbatohet vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe territorit të **institucioni** juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë një institucion varësie.

Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rrejt anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisjes vendore, nd për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në rastin e lidhjes kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin ku zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafët 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtim përkatës, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin, d.m.th. **bashkëshortin bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit dhe bashkëjetuesi**

Unë jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrolli i Pasurive, si dhe Ligji Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik".

Në përputhje me to, unë deklaroj këtu se asnjë zyrtar publik, siç përcaktohet në Kapitullin III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk ka ndonjë interes privat, direkt ose indirekt, me personin juridik që unë përfaqësoj këtu.

D: DEKLARATA***Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës***

Deklarata
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:
Operatori ekonomik Shoqëria “Sakuli” sh.p.k garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.
Operatori ekonomik Shoqëria “Sakuli” sh.p.k lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.
Operatori ekonomik Shoqëria “Sakuli” sh.p.k nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nejmshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.
<i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i>

Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit A: DEKLARATË


Në përputhje me specifikimet teknike dhe grafikun e realizimit të objektit të kontratës:

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojnë të gjitha specifikimet teknike, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë (nëse kërkohet nga Autoriteti Kontraktor), dhe marrim përsipër të	Po [X] Jo []
realizojmë objektin në përputhje me Listën e mallrave dhe grafikun e lëvrimit të përcaktuar nga Autoriteti kontraktor.	

B: DEKLARATË

Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)

Deklarata	Përgjigje

<p>Në cilësinë e operatorët ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se: Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të eilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.</p>	<p><u>Punonjës</u> Po [<input checked="" type="checkbox"/>] Jo [<input type="checkbox"/>] <u>Nëse, po, numri i punonjësve:</u> Shoqëria “Sakuli” sh.p.k ka nje numer prej 41 punonjesish. <u>Profili i punonjësve:</u> - Sokol Mecollari — dizenjator, me pervoje pune me shume se 5 vjet, per te cilin gjeni ne dokumentet e ngarkuara ne SPE, CV dhe kontraten e punes, si edhe eshte i pasqyruar ne listepagesat e shoqerise. - Punonjesit e tjere jane te profileve: ekonomist, dizenjues grafik, punetore montimi, punetor adezivi, punetor per geramat 3D, elektrikist, magazinier, etj. Per numrin e punonjesve dhe profilet e tyre gjeni ne dokumentet e ngarkuara ne SPE, listepagesat e 2 muajve te fundit, si edhe vertetimin e kontributeve.</p> <hr/> <p><u>Makineri e miete</u> Po [<input checked="" type="checkbox"/>] Jo [<input type="checkbox"/>] <u>Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete:</u> Makineri shtypi, e marre me kontrate qiraje. Printer dixhital, e marre me kontrate qiraje.</p>
	<p>- Pajisje laminuese, e cila eshte ne pronesi te Shoqerise “Sakuli” sh.p.k., per te cilen gjeni ne dokumentet e ngarkuara ne SPE faturen e blerjes, si edhe foton perkatese.</p>
<p>Emri, Mbiemri: Abe, in Firindzi</p> <p>SI G N PRINTI id G</p> <p>Vula:</p> <p>Data e dorezimit të deklaratës: 07.04.2026</p> 	

Ju lutemi sigurohuni që:

- Secili pjesëmarrës i renditur në një bashkim operatorësh ekonomikë të paraqesë një Formular të veçantë të Vetëdeklarimit.

- Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, një Formular i veçantë i Vetëdeklarimit duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.
- Çdo vetdeklarim i pavërtetë/pasaktë nga ana e operatorëve ekonomikë jo vetëm që përbën shkak për skualifikimin nga procedura konkrete, por përbën shkak dhe për përjashtimin e tyre nga e drejta për të fituar kontrata publike deri në 3 vjet, sipas parashikimeve të ligjit për prokurimin publik.
- Operatorët ekonomikë që ofertojnë në procedurat e prokurimit të vetdeklarojnë në çdo rast informacionin e saktë që i korrespondon gjendjes së tyre faktike.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik për sa më sipër.

- Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike.
- Në procedurat e prokurimit me faza, ky dokumentacion i kërkohet të gjithë kandidatëve të kualifikuar në fazën e parë, përpara nisjes së afateve të ankimit.
- Ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, për dokumentat e ofertës të ngarkuara në Sistemin e Prokurimit Elektronik duhet të dorëzojë dokumentat provuese, të cilat duhet të jenë në origjinal ose në kopje të njehsuara. Ndërsa, dokumentet provuese, që do të paraqiten për të provuar vetëdeklarimet e bëra, duhet të paraqiten në origjinal ose të njehsuara me origjinalin dhe të provojnë gjendjen faktike të ofertuesit në kohën e ofertimit të tij.
- Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

III.1.4 . Në nenin 76 “Kriteret detyruese për skualifikim” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

1. Çdo operator ekonomik që është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përmendura në këtë pikë, skualifikohet nga procedurat e prokurimit publik për një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata. Ky skualifikim bëhet për veprat penale të mëposhtme:

- a) pjesëmarrje në grup të strukturuar kriminal, organizatë kriminale, bandë e armatosur, organizatë terroriste, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;*
- b) korrupsion sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;*
- c) mashtrim sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;*
- ç) pastrim parash ose financim të terrorizmit sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;*
- d) vepra me qëllime terroriste ose vepra penale të lidhura me veprimtari terroriste, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;*
- dh) falsifikim;*
- e) puna e fëmijëve dhe forma të tjera të trafikimit të qenieve njerëzore sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.*

Detyrimi për skualifikimin e një operatori ekonomik zbatohet edhe kur personi i dënuar me një vendim gjyqësor të formës së prerë është anëtar i një organi administrimi, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, operatori ekonomik, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij.

2. Një operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në një procedurë prokurimi kur operatori ekonomik ka shkelur detyrimet e tij në lidhje me pagesën e taksave ose kontributeve të sigurimeve shoqërore, me përjashtim të rasteve, kur:

a) operatori ekonomik është në proces gjyqësor dhe nuk ka një vendim gjyqësor ose administrativ të formës së prerë, sipas legjislacionit në fuqi;

b) operatori ekonomik i ka përmbushur detyrimet e tij, duke paguar ose duke lidhur një marrëveshje detyruese me qëllim pagimin e detyrimeve tatimore që duhet të paguajë, duke përfshirë, aty ku është e zbatueshme, çdo kamatëvonesë ose gjobë. Në çdo rast, marrëveshja detyruese me qëllim pagimin e detyrimeve tatimore duhet të jetë e nënshkruar përpara datës së shpalljes së procedurës së prokurimit;

c) operatori ekonomik nuk ka paguar shuma të vogla tatimesh ose kontributesh të sigurimeve shoqërore deri në vlerën prej 10 000 lekësh;

ç) operatori ekonomik është informuar për shumën e saktë që duhet të paguajë pas shkeljes së detyrimit të tij për të paguar taksat ose kontributet e sigurimeve shoqërore, në një kohë të tillë kur nuk ka pasur mundësi të marrë masat e nevojshme për shlyerjen e tyre, përpara skadimit të afatit për dorëzimin e kërkesës për pjesëmarrje/ofertës.

3. Çdo operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në procedurën e prokurimit nëse është në një nga situatat e mëposhtme:

a) autoriteti ose enti kontraktor provon se ka shkelje të detyrimeve të zbatueshme që lidhen me legjislacionin për mbrojtjen nga diskriminimi, legjislacionin mjedisor, social, të punës, në fuqi apo me marrëveshjet kolektive dhe aktet e së drejtës ndërkombëtare në lidhje me këto fusha, ku Republika e Shqipërisë është palë;

b) operatori ekonomik ka falimentuar ose është subjekt i procedurave të falimentimit, kur asetet e tij administrohen nga një administrator falimentimi ose nga gjykata, kur ekziston një marrëveshje me kreditorët, kur veprimtaritë e tij të biznesit janë pezulluar ose ai ndodhet në një situatë të ngjashme që ka lindur nga një procedurë e ngjashme në zbatim të legjislacionit në fuqi, me përjashtim të rastit të parashikuar në nenin 47, pika 2, shkronja “ç”, të këtij ligji;

c) operatori ekonomik është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi.

ç) autoriteti ose enti kontraktor provon se operatori ekonomik ka lidhur marrëveshje me operatorë ekonomikë të tjerë që kanë si qëllim të shtrembërojnë konkurrencën;

d) operatori ekonomik ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;

dh) operatori ekonomik është tërhequr nga nënshkrimi i kontratës në një procedurë prokurimi të zhvilluar nga vetë autoriteti ose enti kontraktor. Ky kusht zbatohet brenda një viti kalendarik nga tërheqja;

e) operatori ekonomik ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate.

ë) operatori ekonomik ka paraqitur deklaratat të rreme në dhënien e informacionit të kërkuar për të vërtetuar mungesën e arsyeve për skualifikim ose për plotësimin e kriterëve të përzgjedhjes, ka fshehur një informacion të tillë ose nuk është në gjendje të dorëzojë dokumentet provuese sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentet e tenderit;

f) autoriteti kontraktor ka informacion të provuar se operatori ekonomik ka marrë përsipër të ndikojë në mënyrë të gabuar procesin e vendimmarrjes së autoritetit ose entit kontraktor për të marrë informacion konfidencial, që mund t'i japë atij avantazh të padrejtë në procedurën e prokurimit, ose nga pakujdesia të japë informacione të gabuara që mund të kenë ndikim domethënës në vendimet që lidhen me përjashtimin, përzgjedhjen ose prokurimin.

g) operatori ekonomik ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontratat e prokurimit publik, koncesionit/partneritetit publik privat dhe ankandit publik, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

gj) operatori ekonomik nuk ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

h) operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar nuk zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Kategoritë e profesioneve përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrisë përgjegjëse për punën.

4. Në rrethana të jashtëzakonshme, që lidhen me arsye thelbësore të interesit publik, si shëndeti publik apo mbrojtja e mjedisit, të konfirmuara nga autoritetet kompetente, autoriteti ose enti kontraktor mund të vendosë të mos e skualifikojë operatorin ekonomik, pavarësisht parashikimeve të pikës 3 të këtij neni.

5. Autoriteti ose enti kontraktor skualifikon çdo kandidat ose ofertues, që paraqet të dhëna të rreme për qëllime kualifikimi, në çdo kohë, deri në momentin e lidhjes së kontratës dhe raporton në Agjencinë e Prokurimit Publik, për qëllimet e parashikuara në nenin 78 të këtij ligji.

6. Operatori ekonomik që ndodhet në një nga kushtet e skualifikimit të parashikuara në këtë nen mund të paraqesë prova me qëllim për të vërtetuar se masat e marra prej tij janë të mjaftueshme për të treguar besueshmërinë e tij, pavarësisht ekzistencës së kushteve për skualifikim.

Për këtë qëllim, operatori ekonomik duhet të provojë që ka paguar apo ka marrë angazhim të paguajë kompensim për çdo dëm të shkaktuar si pasojë e kryerjes së një veprë penale apo shkeljeje ligjore, që ka sqaruar faktet dhe rrethanat në mënyrë gjithëpërfshirëse duke bashkëpunuar me autoritetet hetimore dhe që ka marrë masa konkrete organizative dhe për personelin të përshtatshme për parandalimin e veprave penale apo shkeljeve të tjera. Masat e marra nga operatori ekonomik duhet të vlerësohen duke marrë parasysh rëndësinë dhe rrethanat e posaçme të veprës penale apo të shkeljes. Nëse masat e marra konsiderohen të pamjaftueshme, operatorit ekonomik i jepen arsyet për një vendim të tillë.

7. Operatori ekonomik, i përjashtuar me vendim përfundimtar nga e drejta për të fituar kontratat e prokurimit publik, koncesionit/partneritetit publik privat dhe ankandit publik nuk ka të drejtë të përdorë mundësinë e parashikuar nga pika 6 e këtij neni gjatë periudhës së përjashtimit të përcaktuar në këtë vendim.

8. Për operatorët ekonomikë të regjistruar në regjistrat tregtarë shqiptarë, Sistemi i Prokurimit Elektronik verifikon automatikisht përmes ndërveprimit me sisteme të tjera përmbushjen e kushteve detyruese për skualifikim.

III.1.5. Në nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoje që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

III.1.6. Në nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht:

“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik.

Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t’i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit. Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

2. Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t’u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës.

3. Pavarësisht pikës 2 të këtij neni, operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër i ka këto dokumente.

4. Në rastin e operatorëve ekonomikë të huaj, dokumentet duhet të paraqiten në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit. Në raste të dokumenteve që nuk lëshohen në vendin e origjinës, ky fakt duhet të provohet prej operatorëve ekonomikë.

5. Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti ose enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari që të dorëzojë:

a) dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike, të cilat në kohën e dorëzimit pranë autoritetit ose entit kontraktor duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre;

b) dokumentet mbështetëse në origjinal ose një kopje të noterizuar të tyre për vetëdeklarimet e dhëna.

Në procedurat e prokurimit me faza, dokumentacioni, sipas shkronjave “a” dhe “b” të kësaj pike, u kërkohet të gjithë kandidatëve të kualifikuar në fazën e parë, përpara nisjes së afateve të ankimit.

6. Për operatorët ekonomikë të regjistruar në regjistrat tregtarë shqiptarë, krijimi dhe plotësimi i formularit përmbledhës të vetëdeklarimit kryhet në Sistemin e Prokurimit Elektronik.

7. Pavarësisht parashikimeve të pikës 5 të këtij neni, operatorëve ekonomikë të regjistruar në regjistrat tregtarë shqiptarë nuk u kërkohet të paraqesin dokumente mbështetëse ose prova të tjera dokumentare për atë pjesë të informacionit të deklaruar dhe të gjeneruar automatikisht në Sistemin e Prokurimit Elektronik si pjesë e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit nga ndërveprimi me sisteme të tjera elektronike.

8. Operatorët ekonomikë mund të përmbushin kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit edhe nëpërmjet dosjes virtuale të operatorit, e krijuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik përmes ndërveprimit me sisteme të tjera elektronike për ruajtjen e dokumenteve.

Dokumentet e dorëzuara si pjesë e dosjes virtuale të operatorit duhet të jenë të gjeneruara nga sisteme të tjera elektronike ose të noterizuara përmes ndërveprimit me sistemin elektronik të Dhomës Kombëtare të Noterisë.

Operatorët ekonomikë janë përgjegjës për përditësimin e të dhënave në mënyrë automatike, për aq sa është e mundur, në dosjen virtuale të operatorit.

9. Për operatorët ekonomikë vendës, Sistemi i Prokurimit Elektronik verifikon automatikisht përmes ndërveprimit me sisteme të tjera përmbushjen e kushteve detyruese për skualifikim dhe kriteret e veçanta të kualifikimit për aq sa është e zbatueshme.

10. Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti ose enti kontraktor për operatorët ekonomikë të huaj i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari që të dorëzojë pranë autoritetit kontraktor në origjinal ose kopje të noterizuar dokumentet e paraqitura në rrugë elektronike, të cilat nuk mund të gjenerohen automatikisht nga sistemet e tjera me anë të ndërveprimit. Dokumentet e noterizuara para noterëve publikë të Republikës së Shqipërisë dorëzohen online në Sistemin e Prokurimit Elektronik përmes ndërveprimit me sistemin elektronik të Dhomës Kombëtare të Noterisë.

Në procedurat e prokurimit me faza, dokumentacioni sipas pikës 5 u kërkohet të gjithë kandidatëve të kualifikuar në fazën e parë, përpara nisjes së afateve të ankimit.

11. Autoriteti ose enti kontraktor do të përdorë sistemin e-Certis për të marrë informacion për llojet dhe format e provave të përmendura në këtë nen dhe për autoritetet kompetente, që i lëshojnë ato në shtetet anëtare të Bashkimit Evropian.”

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.”

III.1.7. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se:

“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarimin, si më poshtë vijon:
a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit

ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

ç) operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;

d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;

e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;

h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);

i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;

j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;

k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi;

l) operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;

ll) operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.

6. Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Në procedurat e prokurimit me faza, ky dokumentacion i kërkohet të gjithë kandidatëve të kualifikuar në fazën e parë, përpara nisjes së afateve të ankimit. Ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë dokumentat provuese, të cilat duhet të jenë në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

Për dokumentat e ofertës, të ngarkuara në sistemin e prokurimit elektronik, ofertuesi i kualifikuar i pari duhet t'i paraqesë këto dokumenta në origjinal ose të njësuara me origjinalin. Gjithashtu, dokumentet provuese, që do të paraqiten për të provuar vetëdeklarimet e bëra, duhet të paraqiten në origjinal ose të njësuara me origjinalin dhe të provojnë gjendjen faktike të ofertuesit në kohën e ofertimit të tij. Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike. Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj. Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

7. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.”

III.1.8. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim, ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.1.9. Në rastin konkret referuar pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues “Inpress” SHPK, Komisioni konstaton, se operatori ekonomik “SAKULI” SHPK ka ngarkuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik, Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit që autoriteti kontraktor ka përcaktuar në dokumentat standarte të tenderit objekt prokurimi. Në këtë formular, vërehet se operatori ekonomik “SAKULI” SHPK ka dhënë informacion për plotësimin e të gjithë rubrikave të mësipërme që lidhen me plotësimin e kërkesave të përgjithshme të kualifikimit duke përcaktuar dokumentin konkret, autoritetin lëshues apo dokumentin konkret të institucionit nga janë siguruar të dhënat duke dhënë indicie për institucionin apo dokumentacionin konkret mbi bazën e cilit do të kryhet verifikimi në fazën tjetër të vlerësimit të dokumentacionit të dorëzuar në autoritet përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit. Referuar sa më sipër, Komisioni i

Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik “SAKULI” SHPK plotëson kriteret e përgjithshme të kualifikimit sipas kërkesave të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, pjesë e dokumenteve të tenderit, duke dhënë të dhënat e nevojshme për rubrikat e cituara më sipër në këtë vendim sic ky formular parashikon. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kriteret kualifikuese dhe kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me kërkesat e dokumenteve të tenderit dhe legjislacionin në fuqi. KPP gjykon se kriteret e veçanta për kualifikim kanë si synim kryesor që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Sa më lart KPP gjykon se operatori ekonomik “SAKULI” SHPK ka plotësuar të gjitha rubrikat e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit lidhur me plotësimin e kritereve të përgjithshme të kualifikimit në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator si dhe me dokumentet standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi. Nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, dokumentet e tenderit, si dhe informacioni dhe dokumentacioni i dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, konstaton se operatori ekonomik “SAKULI” SHPK, si operator ekonomik i kualifikuar i pari në këtë procedurë prokurimi, në zbatim të nenit 26 pika 6 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ka paraqitur pranë autoritetit kontraktor dokumentet provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, në Pjesën II, A, parashikohet “Deklaratë për përmbushjen e kritereve të përgjithshme”. Pas verifikimit dhe shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik nga operatori ekonomik “SAKULI” SHPK, si dhe dokumentacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor nëpërmjet shkresës nr. 4911/12 prot, datë 14.05.2026, protokolluar me tonën me nr. 1274/4 prot, datë 15.05.2026, Komisioni i Prokurimit Publik pasi verifikoi dokumentacionin e ardhur nga autoriteti kontraktor gjykon, se operatori ekonomik “SAKULI” SHPK me dokumentacionin e dorëzuar në autoriteti kontraktor, i cili shërben si provë për vertetimin e deklarimeve të bëra në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, i përmush kërkesat e autoritetit kontraktor.. Sa më lart KPP gjykon se operatori ekonomik “SAKULI” SHPK ka plotësuar Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 10 të dokumentave standarde të tenderit në të gjitha rubrikat lidhur me plotësimin e kritereve të përgjithshme të kualifikimit duke dhënë informacionin që ky formular kërkon, si dhe ka paraqitur dokumentacion për këtë kriter pranë autoritetit kontraktor referuar informacionit të dërguar nga ky i fundit në KPP. Në këtë kuadër, operatori ekonomik “SAKULI” SHPK i kualifikuar i pari, nga verifikimi i dokumentacionit provues të dorëzuar pranë autoritetit kontraktor për përmbushjen e kritereve të përgjithshme të kualifikimit të cilat si më sipër kanë shërbyer si objekt i ankesës dhe nga deklaratimet e bëra në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit për përmbushjen e këtyre kritereve, konsiderohet dokumentacion i vlefshëm, duke përmbushur kërkesat e autoritetit kontraktor.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Inpress” SHPK se: “...OE Sakuli shpk. do të duhet të skualifikohet në zbatim të Nenit 76, pika 3/h, të të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet: “h. operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar nuk zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Kategoritë e profesioneve përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrisë përgjegjëse për punën. ...pasi, ky operator ekonomik nuk respekton dhe zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.....”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në shtojcën “Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit”, gërma “dh” dhe “g” e dokumentave të procedurës së prokurimit, është parashikuar si vijon:

[...] Ofertuesi deklaron se:

dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;

g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.[...]

III.2.2. Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimeve elektronike si dokumentacionit të dorëzuar fizikisht pranë autoritetit kontraktor nga operatorit ekonomik i kualifikuar i pari “Sakuli” SHPK, konstatohet se ky operator ekonomik ka dorëzuar:

- Shtojca 10 Formualri Përmbledhës Vetëdeklarimit i plotësuar në të gjitha fushat i firmosur dhe vulosur.

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata

<p>Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i></p> <p>Ekstrakt tregtar — Qendra Kombetare e Biznesit</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i></p> <p>Vertetim civil — Gjykata e Juridiksionit te Pergjithshem Tirane</p>
<p>Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:</p> <p>Abedin Sakuli — ortak dhe administrator etj.</p> <p>nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i></p>
<p>Vertetim civil - Gjykata e Juridiksionit te Pergjithshem Tirane</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i></p> <p>Vendim civil dhe penal — Gjykata e Juridiksionit te Pergjithshem Tirane</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i></p> <p>Vertetim statusi aktiv — Drejtoria Rajonale e Tatimeve Tirane</p> <p>Vertetim falimenti dhe Vertetim likuidimi - Gjykata e Juridiksionit te Pergjithshem Tirane</p>
<p>Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i></p> <p>Vertetim per kontributet e sigurimeve shoqerore dhe shendetesore - Drejtoria Rajonale e Tatimeve Tirane Vertetim per pagesen e taksave vendore — Bashkia Vore</p>

<p>Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.</p> <p>Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i></p> <p>Vertetim debie — Operatori i OSHEE</p>
<p>Operatori Ekonomik nuk ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i></p> <p>Shoqëria “SAKULI” sh.p.k nuk ka asnjë rast të mëparshëm të mangësive apo vonese në realizimin e kontratave publike.</p>
<p>Operatori ekonomik ka regjistruar pronarit përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i></p> <p>Ekstrakt i regjistrimit të pronarit përfitues — Qendra Kombëtare e Biznesit</p>
<p>Operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i></p> <p>Listpagesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore — Drejtoria Rajonale e Tatimeve Tirane</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.</p> <p>Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetencë përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i></p> <p>Vertetim mosperjashtimi — Agjencia e Prokurimit Publik</p>
<p>Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i></p> <p>Certifikata ISO9001:2015 — Certifikuar për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë (ICDQ)</p> <p>Certifikata ISO14001:2015 — Certifikuar për Menaxhimin e Sigurisë dhe Shëndetit në Punë (ICDQ)</p> <p>Certifikate ISO45001:2018 — Certifikuar për Sistemin e Menaxhimit Mjedisor (ICDQ)</p>

- Dokumentacioni fizik i operatorit ekonomik “SAKULI” SHPK dorëzuar pranë autoritetit kontraktor dhe ardhur me shkresën nr. 4911/1 prot, datë 14.05.2026, protokolluar me tonën me nr. 1274/4 prot, datë 15.05.2026, ku ndër të tjera është dorëzuar edhe dokumenti:
 - Vërtetim nr.T15380059, datë 27.03.2026 (Për kontributet e Sigurimeve Shoqërore për tatimpaguesin –E-SIG 02/a), lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.
 - Listpagesa e Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore, Shëndetsore dhe Tatimit mbi të Ardhurat nga Punësimi për muajin shkurt 2026

III.2.3. Në nenin 76 “Kriteret detyruese për skualifikim” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

1. Çdo operator ekonomik që është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përmendura në këtë pikë, skualifikohet nga procedurat e prokurimit publik për një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata. Ky skualifikim bëhet për veprat penale të mëposhtme:

a) pjesëmarrje në grup të strukturuar kriminal, organizatë kriminale, bandë e armatosur, organizatë terroriste, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;

b) korrupsion sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;

c) mashtrim sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;

ç) pastrim parash ose financim të terrorizmit sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;

d) vepra me qëllime terroriste ose vepra penale të lidhura me veprimtari terroriste, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;

dh) falsifikim;

e) puna e fëmijëve dhe forma të tjera të trafikimit të qenieve njerëzore sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.

Detyrimi për skualifikimin e një operatori ekonomik zbatohet edhe kur personi i dënuar me një vendim gjyqësor të formës së prerë është anëtar i një organi administrimi, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, operatori ekonomik, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij.

2. Një operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në një procedurë prokurimi kur operatori ekonomik ka shkelur detyrimet e tij në lidhje me pagesën e taksave ose kontributeve të sigurimeve shoqërore, me përjashtim të rasteve, kur:

a) operatori ekonomik është në proces gjyqësor dhe nuk ka një vendim gjyqësor ose administrativ të formës së prerë, sipas legjislacionit në fuqi;

b) operatori ekonomik i ka përmbushur detyrimet e tij, duke paguar ose duke lidhur një marrëveshje detyruese me qëllim pagimin e detyrimeve tatimore që duhet të paguajë, duke përfshirë, aty ku është e zbatueshme, çdo kamatëvonesë ose gjobë. Në çdo rast, marrëveshja detyruese me qëllim pagimin e detyrimeve tatimore duhet të jetë e nënshkruar përpara datës së shpalljes së procedurës së prokurimit;

c) operatori ekonomik nuk ka paguar shumën të vogla tatimesh ose kontributesh të sigurimeve shoqërore deri në vlerën prej 10 000 lekësh;

ç) operatori ekonomik është informuar për shumën e saktë që duhet të paguajë pas shkeljes së detyrimit të tij për të paguar taksat ose kontributet e sigurimeve shoqërore, në një kohë të tillë kur nuk ka pasur mundësi të marrë masat e nevojshme për shlyerjen e tyre, përpara skadimit të afatit për dorëzimin e kërkesës për pjesëmarrje/ofertës.

3. Çdo operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në procedurën e prokurimit nëse është në një nga situatat e mëposhtme:

a) autoriteti ose enti kontraktor provon se ka shkelje të detyrimeve të zbatueshme që lidhen me legjislacionin për mbrojtjen nga diskriminimi, legjislacionin mjedisor, social, të punës, në fuqi apo me marrëveshjet kolektive dhe aktet e së drejtës ndërkombëtare në lidhje me këto fusha, ku Republika e Shqipërisë është palë;

b) operatori ekonomik ka falimentuar ose është subjekt i procedurave të falimentimit, kur asetet e tij administrohen nga një administrator falimentimi ose nga gjykata, kur ekziston një marrëveshje me kreditorët, kur veprimtaritë e tij të biznesit janë pezulluar ose ai ndodhet në një situatë të ngjashme që ka lindur nga një procedurë e ngjashme në zbatim të legjislacionit në fuqi, me përjashtim të rastit të parashikuar në nenin 47, pika 2, shkronja “ç”, të këtij ligji;

c) operatori ekonomik është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi.

ç) autoriteti ose enti kontraktor provon se operatori ekonomik ka lidhur marrëveshje me operatorë ekonomikë të tjerë që kanë si qëllim të shtrembërojnë konkurrencën;

d) operatori ekonomik ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;

dh) operatori ekonomik është tërhequr nga nënshkrimi i kontratës në një procedurë prokurimi të zhvilluar nga vetë autoriteti ose enti kontraktor. Ky kusht zbatohet brenda një viti kalendarik nga tërheqja;

e) operatori ekonomik ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate.

ë) operatori ekonomik ka paraqitur deklaratat të rreme në dhënien e informacionit të kërkuar për të vërtetuar mungesën e arsyeve për skualifikim ose për plotësimin e kriterëve të përzgjedhjes, ka fshehur një informacion të tillë ose nuk është në gjendje të dorëzojë dokumentet provuese sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentet e tenderit;

f) autoriteti kontraktor ka informacion të provuar se operatori ekonomik ka marrë përsipër të ndikojë në mënyrë të gabuar procesin e vendimmarrjes së autoritetit ose entit kontraktor për të marrë informacion konfidencial, që mund t'i japë atij avantazh të padrejtë në procedurën e prokurimit, ose nga pakujdesia të japë informacione të gabuara që mund të kenë ndikim domethënës në vendimet që lidhen me përjashtimin, përzgjedhjen ose prokurimin.

g) operatori ekonomik ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontratat e prokurimit publik, koncesionit/partneritetit publik privat dhe ankandit publik, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

gj) operatori ekonomik nuk ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

h) operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar nuk zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Kategoritë e profesioneve përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrisë përgjegjëse për punën.

4. Në rrethana të jashtëzakonshme, që lidhen me arsye thelbësore të interesit publik, si shëndeti publik apo mbrojtja e mjedisit, të konfirmuara nga autoritetet kompetente, autoriteti ose enti kontraktor mund të vendosë të mos e skualifikojë operatorin ekonomik, pavarësisht parashikimeve të pikës 3 të këtij neni.

5. Autoriteti ose enti kontraktor skualifikon çdo kandidat ose ofertues, që paraqet të dhëna të rreme për qëllime kualifikimi, në çdo kohë, deri në momentin e lidhjes së kontratës dhe raporton në Agjencinë e Prokurimit Publik, për qëllimet e parashikuara në nenin 78 të këtij ligji.

6. Operatori ekonomik që ndodhet në një nga kushtet e skualifikimit të parashikuara në këtë nen mund të paraqesë prova me qëllim për të vërtetuar se masat e marra prej tij janë të mjaftueshme për të treguar besueshmërinë e tij, pavarësisht ekzistencës së kushteve për skualifikim.

Për këtë qëllim, operatori ekonomik duhet të provojë që ka paguar apo ka marrë angazhim të paguajë kompensim për çdo dëm të shkaktuar si pasojë e kryerjes së një veprë penale apo shkeljeje ligjore, që ka sqaruar faktet dhe rrethanat në mënyrë gjithëpërfshirëse duke bashkëpunuar me autoritetet hetimore dhe që ka marrë masa konkrete organizative dhe për personelin të përshtatshme për parandalimin e veprave penale apo shkeljeve të tjera. Masat e marra nga operatori ekonomik duhet të vlerësohen duke marrë parasysh rëndësinë dhe rrethanat e posaçme të veprës penale apo të shkeljes. Nëse masat e marra konsiderohen të pamjaftueshme, operatorit ekonomik i jepen arsyet për një vendim të tillë.

7. Operatori ekonomik, i përjashtuar me vendim përfundimtar nga e drejta për të fituar kontratat e prokurimit publik, koncesionit/partneritetit publik privat dhe ankandit publik nuk ka të drejtë të përdorë mundësinë e parashikuar nga pika 6 e këtij neni gjatë periudhës së përjashtimit të përcaktuar në këtë vendim.

8. Për operatorët ekonomikë të regjistruar në regjistrat tregtarë shqiptarë, Sistemi i Prokurimit Elektronik verifikon automatikisht përmes ndërveprimit me sisteme të tjera përmbushjen e kushteve detyruese për skualifikim.

III.2.4. Në nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht:

1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik.

Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t’i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit. Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

2. Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t’u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës.

3. Pavarësisht pikës 2 të këtij neni, operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër i ka këto dokumente.

4. Në rastin e operatorëve ekonomikë të huaj, dokumentet duhet të paraqiten në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit. Në raste të dokumenteve që nuk lëshohen në vendin e origjinës, ky fakt duhet të provohet prej operatorëve ekonomikë.

5. Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti ose enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari që të dorëzojë:

a) dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike, të cilat në kohën e dorëzimit pranë autoritetit ose entit kontraktor duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre;

b) dokumentet mbështetëse në origjinal ose një kopje të noterizuar të tyre për vetëdeklarimet e dhëna.

Në procedurat e prokurimit me faza, dokumentacioni, sipas shkronjave “a” dhe “b” të kësaj pike, u kërkohet të gjithë kandidatëve të kualifikuar në fazën e parë, përpara nisjes së afateve të ankimit.

6. Për operatorët ekonomikë të regjistruar në regjistrat tregtarë shqiptarë, krijimi dhe plotësimi i formularit përmbledhës të vetëdeklarimit kryhet në Sistemin e Prokurimit Elektronik.

7. Pavarësisht parashikimeve të pikës 5 të këtij neni, operatorëve ekonomikë të regjistruar në regjistrat tregtarë shqiptarë nuk u kërkohet të paraqesin dokumente mbështetëse ose prova të tjera dokumentare për atë pjesë të informacionit të deklaruar dhe të gjeneruar automatikisht në Sistemin e Prokurimit Elektronik si pjesë e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit nga ndërveprimi me sisteme të tjera elektronike.

8. Operatorët ekonomikë mund të përmbushin kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit edhe nëpërmjet dosjes virtuale të operatorit, e krijuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik përmes ndërveprimi me sisteme të tjera elektronike për ruajtjen e dokumenteve.

Dokumentet e dorëzuara si pjesë e dosjes virtuale të operatorit duhet të jenë të gjeneruara nga sisteme të tjera elektronike ose të noterizuara përmes ndërveprimi me sistemin elektronik të Dhomës Kombëtare të Noterisë.

Operatorët ekonomikë janë përgjegjës për përditësimin e të dhënave në mënyrë automatike, për aq sa është e mundur, në dosjen virtuale të operatorit.

9. Për operatorët ekonomikë vendës, Sistemi i Prokurimit Elektronik verifikon automatikisht përmes ndërveprimi me sisteme të tjera përmbushjen e kushteve detyruese për skualifikim dhe kriterëve të veçanta të kualifikimit për aq sa është e zbatueshme.

10. Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti ose enti kontraktor për operatorët ekonomikë të huaj i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari që të dorëzojë pranë autoritetit kontraktor në origjinal ose kopje të noterizuar dokumentet e paraqitura në rrugë elektronike, të cilat nuk mund të gjenerohen automatikisht nga sistemet e tjera me anë të ndërveprimi. Dokumentet e noterizuara para noterëve publikë të Republikës së Shqipërisë dorëzohen online në Sistemin e Prokurimit Elektronik përmes ndërveprimi me sistemin elektronik të Dhomës Kombëtare të Noterisë.

Në procedurat e prokurimit me faza, dokumentacioni sipas pikës 5 u kërkohet të gjithë kandidatëve të kualifikuar në fazën e parë, përpara nisjes së afateve të ankimit.

11. Autoriteti ose enti kontraktor do të përdorë sistemin e-Certis për të marrë informacion për llojet dhe format e provave të përmendura në këtë nen dhe për autoritetet kompetente, që i lëshojnë ato në shtetet anëtare të Bashkimit Evropian.”

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.”

III.2.5. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se:

“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarimin, si më poshtë vijon:

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

ç) operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;

d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;

e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;

h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);

i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;

j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;

k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi;

l) operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;

ll) operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.

6. Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Në procedurat e prokurimit me faza, ky dokumentacion i kërkohet të gjithë kandidatëve të kualifikuar në fazën e parë, përpara nisjes së afateve të ankimit. Ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë dokumentat provuese, të cilat duhet të jenë në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin. Për dokumentat e ofertës, të ngarkuara në sistemin e prokurimit elektronik, ofertuesi i kualifikuar i pari duhet t'i paraqesë këto dokumenta në origjinal ose të njësuar me origjinalin. Gjithashtu, dokumentet provuese, që do të paraqiten për të provuar vetëdeklarimet e bëra, duhet të paraqiten në origjinal ose të njësuar me origjinalin dhe të provojnë gjendjen faktike të ofertuesit në kohën e ofertimit të tij. Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike. Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj. Për 25 dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

7. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.”

III.2.6. Në vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 776, datë 19.12.2025 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi” është parashikuar shprehisht që:

1. Paga bazë minimale mujore për punonjësit në shkallë vendi, që është e detyrueshme të zbatohet nga çdo person, juridik a fizik, vendas ose i huaj, të jetë 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë.

2. Paga bazë minimale mujore jepet për 174 (njëqind e shtatëdhjetë e katër) orë pune në muaj, të kryera gjatë kohës normale të punës. 3. Paga bazë minimale orare të jetë 287.3 (dyqind e tetëdhjetë e shtatë pikë tre) lekë.

4. Shtesat me karakter të përhershëm jepen mbi pagën bazë.

III.2.7. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim, ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.2.8. Në rastin konkret referuar pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues "Inpress" SHPK, Komisioni konstaton, se operatori ekonomik "SAKULI" SHPK ka ngarkuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik, Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit në të cilën ndër të tjera ka deklaruar se *Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së si dhe Operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë* Për vërtetimin e këtyre dy rubrikave operatori ekonomik "SAKULI" SHPK ka dorëzuar dokumentacionin Listepagesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shendetesore lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Tirane si dhe Listepagesën e Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore, Shëndetsore dhe Tatimit mbi të Ardhurat nga Punësimi për muajin shkurt 2026. Referuar vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 776, datë 19.12.2025 "Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi" ku është përcaktuar që paga bazë minimale mujore për punonjësit në shkallë vendi, që është e detyrueshme të zbatohet nga çdo person, juridik a fizik, vendas ose i huaj, të jetë 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë si dhe verifikimit të listepagesës së dorëzuar nga operatori ekonomik "SAKULI" SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se pagat e punonjësve të deklaruar nga ky operator ekonomik janë në përputhje të plotë me vendimi e e sipërcituar.

Përsa i përket pretendimit të ankimuesit se operatori ekonomik nuk zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë, komisioni gjykon se për sa kohë nuk ka një akt ligjor që të rregullojë pagat e punonjësve për kategori profesioni, Komisioni i Prokurimit Publik nuk ka sesi të marrë në konsideratë këtë pretendim për të skualifikuar një operator ekonomik.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Inpress” SHPK se: *kemi bindjen që Sakuli shpk. nuk disponon personelin teknik të nevojshëm ”Dizenjator”, i cili të figurojë në listëpagesat e muajit të fundit, referuar objektit të prokurimit, të kërkuar në DST Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:*

III.3.1. Në shtojcën “Kriteret e veçanta të kualifikimit” pika 2.1.a të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10;

III.3.2. Në shtojcën “Kriteret e veçanta të kualifikimit” pika 2.3.2 të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi është përcaktuar kriteri si më poshtë:

2.2.2 Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë:

a. Ofertuesi duhet të ketë në stafin e tij një dizenjator, me eksperience të pakten 1 vjecare në fushën e dizenjimit, të punësuar me kohë të plote dhe të përfshirë në listëpagesa për muajin e fundit të deklaruara sipas legjislacionit në fuqi.

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

-Kontraten e punës

-CV

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 10 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese, të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j”, të pikës 2, të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”..

III.3.3. Nga verifikimet e kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (S.P.E) për plotësimin e kriterit të mësipërm, operatori ekonomik “SAKULI” SHPK ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të operatorit ekonomik “SAKULI”SHPK, në të cilin në Pjesën III, B: Deklaratë “Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme për realizimin e punimeve objekt kontrate”, ka deklaruar si më poshtë:

B: DEKLARATË

Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)

Deklarata	Përgjigje
<p>ë cilësinë e operatorët ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se: Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të eililn do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.</p>	<p><u>Punonjës</u> Po [X] Jo [] Nëse, po, numri i punonjësve:</p> <hr/> <p>Shoqeria “Sakuli” sh.p.k ka nje numer prej 41 punonjesish. Profili i punonjësve: - Sokol Meçollari — dizenjator, me pervoje pune me shume se 5 vjet, per te cilin gjeni ne dokumentet e ngarkuara ne SPE, CV dhe kontraten e punes, si edhe eshte i pasqyruar ne listepagesat e shoqerise. - Punonjesit e tjere jane te profileve: ekonomist, dizenjues grafik, punetore montimi, punetor adezivi, punetor per gjerat 3D, elektrikist, magazinier, etj. Per numrin e punonjesve dhe profilet e tyre gjeni ne dokumentet e ngarkuara ne SPE, listepagesat e 2 muajve te fundit, si edhe vertetimin e kontributeve.</p> <hr/> <p><u>Makineri e miete</u> Po [X] Jo [] Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete:</p> <hr/> <p>- Makineri shtypi, e marre me kontrate qiraje. - Printer dixhital, e marre me kontrate qiraje. - Pajisje laminuese, e cila eshte ne pronesi te Shoqerise “Sakuli” sh.p.k., per te cilin gjeni ne dokumentet e ngarkuara ne SPE faturen e blerjes, si edhe foton perkatese</p>

III.3.4. Në zbatim të shkresës Nr. 1274/3, datë 12.05.2026, autoriteti kontraktor Bashkia Korçë, me shkresën nr. 4911/1 prot, datë 14.05.2026 me objekt “Dërgim dokumentacioni”, protokolluar me tonën me nr. 1274/4 prot, datë 15.05.2026 ka depozituar dokumentacioni e kërkuar për operatorin ekonomik të renditur i pari “SAKULI” SHPK. Referuar dokumenteve Komisioni konstaton, se në përmbushje të kriterit për kualifikim, 2.3.2 (për të cilat ankimuesi ngre pretendime) janë paraqitur dokumentet si vijon:

- Kontratë Individuale Pune nr.9 prot., datë 06.01.2021 lidhur ndërmjetë punëdhënësit “SAKULI” SHPK dhe punëmarrësit “Sokol Meçollari”, me afat të papërcaktuar, me funksion Dizenjues grafikësh;
- CV për z. Sokol Meçollari
- Listpagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetsore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi për muajin shkurt 2026

III.3.5. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se:
Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.3.6. Në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.
2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.
3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.3.7. Në nenin 77, pika 4 dhe 5 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual.

Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

III.3.8. Neni 41 “Kërkesa të vecanta për kontratat e shërbimeve”, të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se:

“1. Në procedurat e prokurimit për shërbime, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë qartë në termat e referencës, natyrën, objektin, qëllimin, specifikimet teknike dhe afatet kohore të shërbimit që do të kryhet.

2. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

3. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara. Në rastin e procedurave të prokurimit “Shërbim konsulence”, si përvojë e mëparshme për shërbimet e ngjashme me objektin e prokurimit do të njihen dhe/ose shërbimet e ngjashme me fushat përkatëse të ekspertizës, pjesë e objektit të prokurimit.

4. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

d) Në rastin e procedurës së prokurimit “Shërbim konsulence”, stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.

5. Për të provuar se, operatori ekonomik vepron konform kërkesave të legjislacionit në fuqi, autoriteti/enti kontraktor kërkon që:

a) operatori ekonomik të ketë shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

b) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi.

c) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës.

ç) operatori ekonomik të paraqesë ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi.

6. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

7. Në rastin e prokurimit të kontratave shumëvjeçare, autoriteti/enti kontraktor duhet të hartojë kërkesat për kualifikim në përputhje me fondin total të përlogaritur....

III.3.9. Në nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht :

“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik.”

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: *“3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”*

III.3.10. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se:

“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon:
a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

ç) operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;

d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;

e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;

h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);

i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;

j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;

k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi;

l) operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;

ll) operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.

6. Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Në procedurat e prokurimit me faza, ky dokumentacion i kërkohet të gjithë kandidatëve të kualifikuar në fazën e parë, përpara nisjes së afateve të ankimit. Ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë dokumentat provuese, të cilat duhet të jenë në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin. Për dokumentat e ofertës, të ngarkuara në sistemin e prokurimit elektronik, ofertuesi i kualifikuar i pari duhet t’i paraqesë këto dokumenta në origjinal ose të njehsuara me origjinalin. Gjithashtu, dokumentet provuese, që do të paraqiten për të provuar vetëdeklarimet e bëra, duhet të paraqiten në origjinal ose të njehsuara me origjinalin dhe të provojnë gjendjen faktike të ofertuesit në kohën e ofertimit të tij. Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike. Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj. Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

7. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t’i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.”

III.3.11. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim, ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar, Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton, se për përmbushjen e kriterit 2.2.2 Aftësitë teknike dhe profesionale të kriterëve të veçanta të kualifikimit, si më sipër cituar, operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, dokument të cilin në zbatim të parashikimeve ligjore në fuqi, autoriteti/enti kontraktor e pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, dhe vetëm përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26, të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike, duke i rezervuar në këtë mënyrë të drejtën autoritetit kontraktor të kryejë verifikime në rast nevojë apo të dërgojë kërkesa për sqarim, mbi dokumentacionin e paraqitur nga operatorët ekonomikë. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE, Komisioni konstaton, se operatori ekonomik ankimues me dorëzimin e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ka plotësuar të gjitha të dhënat e mundshme që parashikon formulari përmbledhës i vetëdeklarimit, konkretisht ka deklaruar punonjësin që disponon, si dhe profilin e parashikuara në pikën 2.2.2 të kriterëve të veçanta të kualifikimit, të dokumenteve të tenderit, gjithashtu autoriteti kontraktor ka dorëzuar pranë Komisionit dokumentacion e dorëzuar nga ana e operatorit ekonomik “SAKULI” SHPK, si operator i kualifikuar i pari, në zbatim të përcaktimeve ligjore.

III.3.12. Nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, dokumentet e tenderit, si dhe informacioni dhe dokumentacioni i dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, konstatohet, se operatori ekonomik “SAKULI” SHPK, si operator ekonomik i kualifikuar i pari në këtë procedurë prokurimi, në zbatim të nenit 26, pika 6, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ka paraqitur pranë autoritetit kontraktor dokumentet provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Nga shqyrtimi i këtij dokumentacioni, konstatohet, se operatori ekonomik “SAKULI” SHPK, në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, të secilit prej tyre, në Pjesën III, B: Deklaratë Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme, ka deklaruar stafin që disponon. Referuar pretendimeve të ankimuesit, konkretisht, operatori ekonomik “SAKULI” SHPK ka deklaruar se disponon 1 (një) punonjës Dizajner, konkretisht z. Sokol Meçollari. Duke qenë se operatori ekonomik “SAKULI” SHPK është kualifikuar i pari në procedurën e prokurimit, KPP në kuadër të shqyrtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues, për skualifikimin e operatorit ekonomik “SAKULI” SHPK, nëpërmjet shkresës me nr. 4911/1 prot., datë 14.05.2026, protokolluar me tonën me nr. 1274/4 prot datë 15.05.2026, me objekt “Dërgim dokumentacioni”, autoriteti kontraktor, ka paraqitur pranë KPP-së dokumentacionin e dorëzuar pranë autoritetit kontraktor nga operatori ekonomik “SAKULI” SHPK, si operator ekonomik të kualifikuar i pari në këtë procedurë prokurimi. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të mësipërm, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor, si dhe nisur nga pretendimet e ankimuesit, konstatohet se operatori ekonomik “SAKULI” SHPK, në përmbushje të kriterit për punonjësit e mësipërm në dokumentet e tenderit, referuar deklarimit në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, për 1 (një) punonjës dizajner, ku operatori ekonomik “SAKULI” SHPK, në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit ka deklaruar z. Sokol Meçollari, ku ka paraqitur dokumentacion për një punonjës. Konkretisht: - Kontratë Individuale Pune nr.9 prot., datë 06.01.2021 lidhur ndërmjetë punëdhënësit “SAKULI” SHPK dhe punëmarrësit “Sokol Meçollari”, me afat të papërcaktuar, me funksion Dizenjues grafikësh; - CV për z. Sokol Meçollari - Listpagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetsore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi për muajin shkurt 2026; Nisur nga pretendimet e ankimuesit Komisioni verifikoi dokumentacionin e sipërcituar të dorëzuar nga ana e autoritetit kontraktor për operatorin ekonomik “SAKULI” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se për përmbushjen e kriterit kualifikues të përcaktuar në pikën 2.2.2 të dokumenteve standarde të tenderit, operatori ekonomik ankimues, “SAKULI” SHPK ka paraqitur “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit” dhe dokumentacion fizik për vërtetimin e deklarimeve konkretisht dhe të punonjësit të kërkuar. Pas verifikimeve të kryera nga ana Komisionit në përfundim të analizës së fakteve përkatëse, Komisioni arrin në konkluzionin, se punonjësi i deklaruar nga ky subjekt është në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor. Për rrjedhojë operatori ekonomik ankimues “SAKULI” Shpk e përmbush kërkesën për kualifikim që operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij nje specialist me titullin “dizajner”. Kjo të vërtetohet me dokumentacion (kontratën e punës, CV dhe listpagesën e muajit të fundit.”. Për sa më sipër argumentuar, operatori ekonomik “SAKULI” SHPK e plotëson kërkesën e autoritetit kontraktor ndaj dhe do të konsiderohet i vlefshëm.

Për sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Inpress” SHPK nuk qëndron.

III.4. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Inpress” SHPK se:

“...OE Sakuli shpk. NUK disponon realisht 2 (dy) prej makinerive / pajisjeve të kërkuara në DST, dhe konkretisht: i. Makineri shtypi, ii. Pajisje laminuese.

Gjithashtu, ne kemi bindjen që OE Sakuli shpk. nuk ka paraqitur pranë AK dokumentacionin e nevojshëm ligjor dhe teknik, me anë të së cilës provohet/vërtetohet disponimi i makinerive / pajisjeve të kërkuar në DST, si dhe dokumentacioni plotësues teknik “foto per secilen nga pajisjet” i kërkuar në DST....”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.4.1. Në shtojcën “Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes/Kualifikimit” pika 2.2 “Aftësitë teknike dhe profesionale” të dokumentave të tenderit, autoriteti kontraktor ka përcaktuar kriterin kualifikues, si më poshtë vijon:

“2.2.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

-Makineri shtypi

-Printer dixhital

-Pajisje laminuese

**Sqarim: Me pajisje laminuese nenkuptohet makineria per plastifikim ose makineria per ngjitje.*

Per pajisjet e mesiperme ofertuesi duhet te paraqese: foto per secilen nga pajisjet shoqeruar me dokumentacionin që vërteton pronësinë ose posedimin mbi pajisjet e mesiperme (psh. fatura blerje,deklaratë zhdoganimi, kontratë qeraje, kontratë dhurimi dhe cdo formë tjetër të parashikuar nga legjislacioni në fuqi për disponimin/posedimin e pasurive të luajtshme)

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 10 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “ Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese, të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j”,të pikës 2, të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”..”.

III.4.2. Nga verifikimet e kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (S.P.E) për plotësimin e kriterit të mësipërm, operatori ekonomik “SAKULI” SHPK ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të operatorit ekonomik “SAKULI”SHPK, në të cilin në Pjesën III, B: Deklaratë “Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme për realizimin e punimeve objekt kontrate”, ka deklaruar si më poshtë:

B: DEKLARATË

Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)

Deklarata	Përgjigje
<p>Në cilësinë e operatorët ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:</p> <p>Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të eilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.</p>	<p><u>Punonjës</u></p> <p>Po [X] Jo []</p> <p>Nëse, po, numri i punonjësve:</p> <hr/> <p>Shoqeria “Sakuli” sh.p.k ka nje numer prej 41 punonjesish.</p> <p>Profili i punonjësve:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Sokol Meçollari — dizenjator, me pervoje pune me shume se 5 vjet, per te cilin gjeni ne dokumentet e ngarkuara ne SPE, CV dhe kontraten e punes, si edhe eshte i pasqyruar ne listepagesat e shoqerise. - Punonjesit e tjere jane te profileve: ekonomist, dizenjues grafik, punetore montimi, punetor adezivi, punetor per germat 3D, elektrikist, magazinier, etj. <p>Per numrin e punonjesve dhe profilet e tyre gjeni ne dokumentet e ngarkuara ne SPE, listepagesat e 2 muajve te fundit, si edhe vertetimin e kontributeve.</p> <hr/> <p><u>Makineri e miete</u></p> <p>Po [X] Jo []</p> <p>Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete:</p> <hr/> <ul style="list-style-type: none"> - Makineri shtypi, e marre me kontrate qiraje. - Printer dixhital, e marre me kontrate qiraje. - Pajisje laminuese, e cila eshte ne pronesi te Shoqerise “Sakuli” sh.p.k., per te cilen gjeni ne dokumentet e ngarkuara ne SPE faturen e blerjes, si edhe foton perkatese

III.4.3. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor dërguar më shkresën nr. 4911/1 prot, datë 14.05.2026 me objekt “Dërgim dokumentacioni”, protokolluar me tonën me nr. 1274/4 prot, datë 15.05.2026, konstatohet se operatori ekonomik “SAKULI” SHPK i kualifikuar i pari, ka dorëzuar pranë autoritetit kontraktor dokumentacionin fizik sipas parashikimeve të nenit 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, për përmbushjen e kritereve kualifikuese të përcaktuara në pikën 2.2.4 “KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT” të Shtojcës “Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes/Kualifikimit” ka dorëzuar

1. për mjetin **Makineri shtypi** e marrë me kontratë qiraje (për të cilin pretendohet nga ankimuesi se nuk nuk e disponon) dokumentacionin si më poshtë vijon:
 - Kontratë qiraje nr.Rep 7344 dhe nr.Kol.4711, datë 07.04.2026 të lidhur ndërmjet Shoqërisë “Express Print” dhe shoqëqrisë “SAKULI”
 - faturë shitje nr.2102, datë 09.12.2013
 - foto të makinerisë.
2. për mjetin **Pajisje laminuese** e cila ëshët në pronësi të shoqërisë “SAKULI” SHPK (për të cilin pretendohet nga ankimuesi se nuk nuk e disponon) dokumentacionin si më poshtë vijon:
 - faturë shitje nr.459, datë 08.07.20211
 - foto të makinerisë.

III.4.4. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efizienzën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”.*

Ndërkohë në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.

3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”.

III.4.5. Në nenin 77, pika 1 dhe pika 4, “Kërkesat për kualifikim” të ligjit 162/2020, “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikon shprehimisht se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”.

III.4.6. Ndërsa në nenin 92/3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”.

III.4.7. Neni 41 “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve”, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar parashikon shprehimisht se:

shprehimisht se:

1. Në procedurat e prokurimit për shërbime, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë qartë në termat e referencës, natyrën, objektin, qëllimin, specifikimet teknike dhe afatet kohore të shërbimit që do të kryhet.

2. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të

përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

3. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara. Në rastin e përvojes së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara. Në rastin e procedurave të prokurimit “Shërbim konsulence”, si përvojë e mëparshme për shërbimet e ngjashme me objektin e prokurimit do të njihen dhe/ose shërbimet e ngjashme me fushat përkatëse të ekspertizës, pjesë e objektit të prokurimit.

4. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

d) Në rastin e procedurës së prokurimit “Shërbim konsulence”, stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.

5. Për të provuar se, operatori ekonomik vepron konform kërkesave të legjislacionit në fuqi, autoriteti/enti kontraktor kërkon që:

a) operatori ekonomik të ketë shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

b) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi.

c) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës.

ç) operatori ekonomik të paraqesë ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi.

6. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriterë të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

7. Në rastin e prokurimit të kontratave shumëvjeçare, autoriteti/enti kontraktor duhet të hartojë kërkesat për kualifikim në përputhje me fondin total të përlogaritur...”.

III.4.8. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.4.9. Nga shqyrtimi i kriterit kualifikues të përcaktuar në pikën 2.2.4 “2.2Aftësitë teknike dhe profesionale” të shtojcës “Formulari i Kriterëve të Përzgjedhjes/Kualifikimit” të dokumentave të tenderit të modifikuara të procedurës së prokurimit objekt ankimi, Komisioni konstaton se autoriteti kontraktor ka kërkuar që operatorët ekonomikë ofertues që të kualifikohen për këtë kriter kualifikues, duhet të dëshmojnë se kanë në pronësi ose me qera ndër të tjera dhe pajisjen si në vijim: “Makineri shtypi, Printer dixhital dhe Pajisje laminuese.”, vërtetuar kjo me nëpërmjet paraqitjes së dokumentacionit si në vijim: “foto per secilen nga pajisjet shoqeruar me dokumentacionin që vërteton pronësinë ose posedimin mbi pajisjet e mesiperme (psh. fatura blerje,deklaratë zhdoganimi, kontratë qeraje, kontratë dhurimi dhe cdo formë tjetër të parashikuar nga legjislacioni në fuqi për disponimin/posedimin e pasurive të luajtshme)”. Duke qenë se operatori ekonomik “SAKULI” SHPK është kualifikuar i pari në procedurën e prokurimit, KPP në kuadër të shqyrtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues, për skualifikimin e operatorit ekonomik “SAKULI” SHPK, nëpërmjet shkresës me nr. 4911/1 prot., datë 14.05.2026, protokolluar me tonën me nr. 1274/4 prot datë 15.05.2026, me objekt “Dërgim dokumentacioni”, autoriteti kontraktor, ka paraqitur pranë KPP-së dokumentacionin e dorëzuar pranë autoritetit kontraktor nga operatori ekonomik “SAKULI” SHPK, si operator ekonomik të kualifikuar i pari në këtë procedurë prokurimi. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të mësipërm, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor, si dhe nisur nga

pretendimet e ankimuesit, konstatohet se operatori ekonomik “SAKULI” SHPK, në përmbushje të kriterit për punonjësit e mësipërm në dokumentet e tenderit, referuar deklarinimit në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, për mjetet, në Formularin Përmbledhës së Vetëdeklarimit ka deklaruar “*Makineri shtypi, Printer dixhital dhe Pajisje laminuese*” Nisur nga pretendimet e ankimuesit Komisioni verifikoi dokumentacionin e sipërcituar të dorëzuar nga ana e autoritetit kontraktor për operatorin ekonomik “SAKULI” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se për përmbushjen e kriterit kualifikues të përcaktuar në pikën 2.2.2 të dokumenteve standarde të tenderit, operatori ekonomik ankimues, “SAKULI” SHPK ka paraqitur “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit” dhe dokumentacion fizik për vërtetimin e deklarinimeve të mjeteve të kërkuara të kërkuara dhe konkretisht “*Makineri shtypi e marrë me kontratë qiraje (për të cilin pretendohet nga ankimuesi se nuk nuk e disponon) dokumentacionin si më poshtë vijon: - Kontratë qiraje nr.Rep 7344 dhe nr.Kol.4711, datë 07.04.2026 të lidhur ndërmjet Shoqërisë “Express Print” dhe shoqërisë “SAKULI”;- faturë shitje nr.2102, datë 09.12.2013;- foto të makinerisë.Pajisje laminuese e cila është në pronësi të shoqërisë “SAKULI” SHPK (për të cilin pretendohet nga ankimuesi se nuk nuk e disponon) dokumentacionin si më poshtë vijon: - faturë shitje nr.459, datë 08.07.2021;- foto të makinerisë.*” Pas verifikimeve të kryera nga ana Komisionit në përfundim të analizës së fakteve përkatëse, Komisioni arrin në konkluzionin, se “SAKULI” SHPK plotëson kriterin e veçantë të kualifikimit të përcaktuar në pikën 2.2.4 të dokumenteve të tenderit të modifikuara të procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

Për sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Inpress” SHPK nuk qëndron.

III.5. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Inpress” SHPK se: “*...Operatori ekonomik Sakuli shpk. nuk ka furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate, për secilin artikull / mall të kërkuar në DST.*”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.5.1. Në shtojcën “Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes/Kualifikimit” pika 2.2.1 “Aftësitë teknike dhe profesionale” të dokumentave të tenderit në dokumentet standarde të tenderit në procedurën e prokurimit objekt - ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

“2.2.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes te njoftimit te kontrates, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së perlllogaritur te kontrates qe prokurohet .

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) *për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të*

plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

-Per kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë gjithashtu edhe Kontraten e Bashkimit te operatoreve ekonomikë.

-Per kontratat e realizuara si Nënkontraktor, Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë gjithashtu edhe Kontratën baze ndermjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor si dhe Miratimin zyrtar si nenkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.”

III.5.2. Në shtojcën 8, “Terma e Referencës” në dokumentet standarde të tenderit në procedurën e prokurimit objekt - ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon:

” Shërbime te printimit dhe publikimit, materiale promocionale ”

N r.	Emertimi	Sasi a	Njes ia	Pershkrimi
1	Karta për pensionistët	500	copë	Materiali PVC i posacem per ID, me fotografi. Printim 4 ngjyrësh . Nivel sigurie relief ne vende te ndryshme. Printimi i kartave do te behet sipas sasise dhe kerkesave i shtrire ne kohe. Operatori ekonomik eshte pergjegjes per dzenjimin dhe pergatitjen e materialit.Operatori ekonomik duhet te paraqitet prane autoritetit kontraktor cdo date 30 te muajit te terheqe informacionet per prodhimin e Kartes te pensionistit sipas kerkesave mujore te qytetareve.Peseritja e Kartave per gabime ne te dhenat eshte pergjegjesi e operatorit ekonomik.
2	Baner	260	m ²	Baner 600gr/m2, printim nga nje ane CMYK, i pajisur ne rastet kur nevojitet me unaza metalike ose mekanizem. Ideimi, dizenjimi dhe printimi i banerit per aktivitetet e bashkise, permasat do te jene sipas kerkeses te autoriteti kontrakues. Psh. 100 cmx200 cm, 150cm x300 cm, 300cmx200 cm, 200cmx400cm, 300 cmx600cm, Banerat nuk duhen te jene me bashkime.Operatori duhet te mbuloje edhe montimin ne vend te banerit sipas kerkeses te AK.
3	Roll up baner	2	copë	Baner rroll up me mekanizem me permasa 220cm x 100cm, e printuar ne film PVC me sfond te zi nga mbrapa, i dizenuar sipas kerkeses se AK për aktivitete te ndryshme te realizuara gjate vitit.
4	Çertifikata format A4	100	copë	Çertifikata format A4 e dizenuar dhe e shtypur ne CMYK sipas listes se vendosur ne dispozicion nga menaxheri i projektit. Leter 400 gsm.

5	Adeziv	80	m ²	Adeziv per kushte te jashtme, printim CMYK, ngjitja do te behet nga operatori ekonomik. Dizenjimi do te jete i ndryshem per sasi dhe modele te ndryshme ne varesi te kerkeses se AK dhe kostoja do te merret persiper nga operatori ekonomik fitues. Operatori fitues duhet te mbuloje dhe montimin ne vend te adezivit sipas kerkeses se AK
6	Fletëpalosje njëfletëshe	1,700	copë	Flete palosje me permasa 10cmx21cm per aktivitetet e Bashkise, me modele te ndryshme te pershtatura sipas aktiviteteve. Leter 350gsm,me printim digital,leter me shkelqim printim ne te dyja anet. Dizenjimi do te jete i ndryshem per sasi dhe modele te ndryshme ne varesi te kerkese te AK dhe kostoja do te merret persiper nga operatori ekonomik fitues. Kerkohet te dorezohet model i printuar para prodhimit nga operatori ekonomik.
7	Fletëpalosje dyfletëshe	700	copë	Fletëpalosje dy fletëshe me format A4 me përmasa 10cm me 21 cm, per aktivitetet e Bashkise, me modele te ndryshme te pershtatura sipas aktiviteteve. Leter 350gsm,me printim digital,leter me shkelqim printim ne te dyja anet. Dizenjimi do te jete ne varesi te kerkese te AK dhe kostoja do te merret persiper nga operatori ekonomik fitues. Kerkohet te dorezohet model i printuar para prodhimit nga operatori ekonomik.
8	Ftesa	1,700	copë	Letër 350gsm me printim dixhital, me shkëlqim ose jo, dizanji dhe permasat do të përcaktohet në varësi të kërkeses të autoritetit kontraktor
9	Broshurë triplete me palosje për promovimin e turizmit	1,900	copë	Trashesia e letres: 350 gr/m2. Lloji i shtypjes: Printim nga te dyja anët. Ana e perparme e kartolines do te kete foto qe perzgjidhet nga AK cila do te jete do jete printim mat pa shkelqim, e dizenuar sipas kerkeses së AK. Menyra e shtypjes: Permasat: 45cm x15cm.
10	City Light (180cm x 120cm)	100	copë	Leter 180 gr/m2 ,permasat 180x120, ngjitja do te behet nga operatori ekonomik,printim CMYK. Dizenjimi do te jete i ndryshem per sasi dhe modele te ndryshme ne varesi te kerkese te AK dhe kostoja do te merret persiper nga operatori ekonomik fitues.
11	Harta të Korçës	6,000	copë	Hartë e qytetit me palosje me informacion dhe legjendë rreth atraksioneve turistike dhe kulturore në qytet sipas orientimeve të Autoritetit Kontraktor. Formati 50cm X 70cm, Leter mat 170gr, e palosur ne 8 pjese.
12	Bexhe staff	170	copë	Lloji i letres Karton 15cmx 10cm printim digital i plastifikuar nga te dyja anet sipas kerkeses se AK. Bexhe te jete e vendosur ne qafore 45cm cope te loguar, gjatesia me trashesi 4 cm sipas kerkeses se AK
13	Varëse çelësash me logo	100	copë	Varëse çelësash me ngjyra të ndryshme font pastel dhe stampim të logos Korça, the Heartland
14	Stilolapsa me logo	210	copë	Stilolaps me ngjyrë të zezë dhe stampim të logos Korça, the Heartland dhe stilolapsa të stampuar me logon e aktiviteteve, e cila do të jetë në varësi të kërkesës së AK

15	Shall i stampuar me logo	25	copë	Shall material najlon me përmasa 30x100 cm të stampuara me logo ose mbishkrim ngjyrë portokalli dhe ngjyre tjetër, në varesi të kërkesës së AK.
16	USB me kuti druri të gdhendur me logo	50	copë	USB flash drive i zakonshëm me kapacitet të 16GB, e vendosur në kuti druri (bambu) me gdhendje dhe stampim logo Korca, the Heartland
17	Bluza (Tshirt) me mbishkrim dhe logo të aktiviteteve full printed	30	copë	Bluza me minge të shkurtra për femra dhe meshkuj, me qepje të dyfishte tek jaka, materiali pambuk dhe me qëndrueshmeri ndaj larjes, me masa të ndryshme, e loguar me me logo Korca, dhe BE të kërkuar sipas udhëzimeve të AK. Bluzat duhet të jenë të bardha
18	Bluza të stampuara	100	copë	Bluza me minge të shkurtra për femra dhe meshkuj, me qepje të dyfishte tek jaka, materiali pambuk dhe me qëndrueshmeri ndaj larjes, me masa të ndryshme, e loguar me imazhin/ grafikën (e gomuar ose e njëtrajtshme me bluzën) printim 3D 1PC të kërkuar sipas udhëzimeve të AK. Ngjyrat e stampimit 3D mund të jenë të ndryshme në varësi të cilësimeve të kompjuterit dhe monitorimit nga organizatorët
19	Çanta beze full printed ekologjike me logo të aktivitetit	50	copë	Çanta materiali beze dhe poliester me përmasa 50*50cm, e stampuar me logon dhe emrin e aktivitetit, stampim 4-ngjyrësh. Dizajni do të jetë në varësi të kërkesës së AK
20	Shirit portokalli në formë fjongo	100	copë	Fjongo simbolike e vogël për ndërgjegjësim kundër dhunës në familje, e destinuar për t'u vendosur në bluzë, xhakët ose veshje të tjera përmes karficës metalike në pjesën e pasme. Produkti përdoret gjatë fushatave sensibilizuese, aktiviteteve publike, eventeve institucionale dhe shpërndarjes në komunitet. Fjongoja duhet të jetë e realizuar nga shirit sateni ose poliester cilësor, me sipërfaqe të lëmuar dhe me shkëlqim të lehtë. Gjerësia e shiritit rekomandohet 1–1.5 cm, ndërsa gjatësia para formimit 8–10 cm, duke krijuar një fjongo të formuar me lartësi rreth 4–5 cm. Forma duhet të jetë klasike sensibilizuese me pjesën e poshtme të prerë drejt ose në formë V. Ngjyra duhet të jetë portokalli, si simbol ndërkombëtar kundër dhunës në familje, me tonalitet të qëndrueshëm dhe rezistent ndaj zbehjes. Në pjesën e pasme duhet të vendoset karficë metalike e vogël (tip gjilpërë me kapëse sigurie), me gjatësi rreth 2 cm, e fiksuar fort me qepje ose ngjitje industriale cilësore, në mënyrë që të mos shpëputet gjatë përdorimit normal. Karficia duhet të jetë funksionale, e sigurt dhe pa elementë të mprehtë të ekspozuar përveç gjilpërës standarde.

21	Fjongo portokalli (Forex 3mm + Adeziv)	22	copë	<p>Produkti duhet të realizohet në formën standarde të simbolit të sensibilizimit , sipas konfigurimit grafik klasik të përbërë nga dy shirita që kryqëzohen në pjesën qendrore të sipërme dhe përfundojnë me dy skaje të zgjatura në pjesën e poshtme. Elementi duhet të ruajë simetri të plotë vizuale, proporcione të balancuara dhe lakime të rregullta, pa deformime apo devijime nga forma e njohur e simbolit. Laku qendror duhet të jetë i qartë dhe i harmonizuar me trashësinë e brezit, ndërsa prerjet në pjesën e poshtme duhet të jenë të realizuara në mënyrë të njëtrajtshme dhe estetike.</p> <p>Materiali i përdorur duhet të jetë forex (PVC i ngurtë) me trashësi 3 mm, i përshtatshëm për përdorim në ambiente të jashtme dhe rezistent ndaj kushteve atmosferike. Materiali duhet të garantojë qëndrueshmëri strukturore, mosdeformim gjatë ekspozimit në rrezatim diellor, lagështirë dhe ndryshime të temperaturës.</p> <p>Elementi duhet të ketë këto përmasa: lartësi totale 75 cm ±5 cm, gjerësi maksimale 40 cm ±5 cm dhe trashësi të brezit 13 cm ±2 cm, duke respektuar proporcionalitetin klasik të simbolit dhe balancën estetike të tij.</p> <p>Ngjyra e elementit duhet të jetë portokalli. Realizimi i ngjyrës/printimit duhet të kryhet me teknologji UV direkt mbi material ose me vinil cilësor të përshtatshëm për ambiente të jashtme, duke garantuar qëndrueshmëri të ngjyrës dhe rezistencë ndaj faktorëve atmosferikë, përfshirë rrezet UV dhe lagështirën.</p> <p>Përpunimi duhet të realizohet me prerje CNC sipas konturit të formës së fjongos, me sipërfaqe të lëmuar dhe pa cepa të mprehtë. Produkti duhet të sigurojë rezistencë minimale prej 30 (tridhjetë) ditësh në ambient të jashtëm pa dëmtime strukturore apo zbehje të konsiderueshme të ngjyrës.</p> <p>Çdo element duhet të dorëzohet i pajisur me elementet e montimit të përfshira në çmim, konkretisht me dy vrima të përforcuara në pjesën e sipërme për fiksime dhe 2–3 fasheta plastike rezistente ndaj rrezeve UV (minimumi 4.8 mm gjerësi), ose alternativisht me sistem adeziv industrial (shirit dopio-faqësh industrial tip 3M VHB).</p>
22	Spila me logo	76	copë	<p>Spila me logo, me stampim me diametër 4 cm. Modeli i spilës dhe logimi i saj do të jetë në varësi të kërkesës së AK, të përcaktuar sipas aktiviteteve, që do të organizohen</p>
23	Kartvizita	200	copë	<p>Kartvizita printim nga te dy anët trashesia e letres: 400 gr/m2 sipas udhëzimit të AK.</p>
24	Kartolinat e fundvitit	4,800	copë	<p>Trashësia e letres: 350 gr/m2. Lloji I shtypjes: Ana e perparme e kartolines do te kete foto qe perzgjidhet nga AK cila do te jete me laminim dhe logo e Bashkise do jete me llakim parcial lluster. Menyra e shtypjes: Nga te dyja anet. Permasat : 22cmx17.5cm. Kartolinat do pajisen me zarfa te personalizuar me emer dhe adrese. Dizenjimi do te</p>

				jete I ndryshem per sasi dhe modele te ndryshme ne varesi te kerkeses te AK dhe kostoja do te merret persiper nga operatori ekonomik fitues.
25	Buletin informues për punën e Këshillit Bashkiak	200	copë	Broshurë informuese që përmban të gjitha aktivitetet e zhvilluara nga Këshilli Bashkiak Korçë të shoqëruara me foto, Formati 21 x 21, leter ngjyre e bardhe cilesore, 30-50 faqe te printuara gjithsej. Printim i fleteve te brendshme mat 200 gsm. me ngjyra CMYK, Kopertina 350 g msq, plastifikuar mat ose luster. Kapja: Me qepje dhe me ngjitje. Dizenjimi sipas kërkesës së AK.
26	Bllaqe shënimi (Java e Evropes)	300	copë	Bllaq shenimesh me format A5, me ngjitje spiraled he me flete te bardha brenda (jo te ndritshme), me kapak te trashë kartoni nje ngjyresh me logon e bashkise dhe logon e BE, si dhe me shkrimin Java e Evropes, Bashkia Korçë

Kontraktori duhet te realizojë shërbimin e kërkuar dhe dorëzimin e materialeve ne perputhje me specifikimet teknike brenda 5 diteve nga kerkesa e derguar (me shkrim ose nepermjet emailit) nga Autoriteti Kontraktor. Materialet te dorezohen nga kontraktori ne bashkine korce, brenda orarit zyrtar te punes.
Ne rastin e materialeve qe kerkojne dizenjim nga kontraktori, kontraktori duhet te marre miratimin e Autoritetit Kontraktor per dizenjimin perpara se te beje printimin e materialeve
Ne rastin e materialeve qe kerkojne dizenjim, Operatori ekonomik DUHEI te dorezoje krahas kopjeve te printuara dhe variantin elektronik te perpunueshem te cdo materiali prane Autoritetit Kontraktor
Cdo produkt i ideuar dhe prodhuar per aktivitetet, festat apo si material promocional eshte pronesi e Bashkise Korce. Shperndarja e ketyre materialeve apo dhe shumefishimi i tyre pa lejen e Bashkise eshte rreptesisht i ndaluar.

III.5.3. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se operatori ekonomik “SAKULI” SHPK, për përmbushjen të kriterit të mësipërm, ka paraqitur dokumentacion si më poshtë vijon:

- Fature_e_fiskalizuar_AGRO_BLEND- Nr.232/2026 me vlere 520 000 lekë pa tvsh
- Fature_e_fiskalizuar_ALBAELETTRICA Nr.1376/2025 me vlere 2 787 684 lekë pa tvsh
- Fature_e_fiskalizuar_BANKA_E_TIRANES_atm Nr.867/2025 me vlere 709 700 lekë pa tvsh
- Fature_e_fiskalizuar_BIGALB_GROUP Nr.1358/2025 me vlere 408 205 lekë pa tvsh
- Fature_e_fiskalizuar_Cinco_Summer Nr.162/2026 me vlere 833 333 lekë pa tvsh
- Fature_e_fiskalizuar_DOMPÉ__ALBANIA Nr.972 me vlere 184 39.03 lekë pa tvsh
- Fature_e_fiskalizuar_INNA_Group_peja Nr.888/2025 me vlere 785 128 lekë pa tvsh
- Fature_e_fiskalizuar_MEGATEK Nr.666/2024 me vlere 1 299 847.16 lekë pa tvsh
- Fature_e_fiskalizuar_SAINTE-GOBAIN Nr.12/2026 me vlere 1 360 000lekë pa tvsh

III.5.4. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë eficientën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit

publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.5.5. Në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se 1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

III.5.6. Në nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

III.5.7. Neni 41 “Kërkesa të vecanta për kontratat e shërbimeve”, të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

1. Në procedurat e prokurimit për shërbime, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë qartë në termat e referencës, natyrën, objektin, qëllimin, specifikimet teknike dhe afatet kohore të shërbimit që do të kryhet.

2. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

3. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara. Në rastin e procedurave të prokurimit “Shërbim konsulence”, si përvojë e mëparshme për shërbimet e ngjashme me objektin e prokurimit do të njihen dhe/ose shërbimet e ngjashme me fushat përkatëse të ekspertizës, pjesë e objektit të prokurimit.

4. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

d) Në rastin e procedurës së prokurimit “Shërbim konsulence”, stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.

5. Për të provuar se, operatori ekonomik vepron konform kërkesave të legjislacionit në fuqi, autoriteti/enti kontraktor kërkon që:

a) operatori ekonomik të ketë shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

b) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi.

c) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës.

ç) operatori ekonomik të paraqesë ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi.

6. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

7. Në rastin e prokurimit të kontratave shumëvjeçare, autoriteti/enti kontraktor duhet të hartojë kërkesat për kualifikim në përputhje me fondin total të përlllogaritur..

III.5.8. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit.

III.5.9. Referuar sa më sipër, Komisioni konstaton, se në dokumentet e tenderit të procedurës objekt-ankimi, autoriteti kontraktor në lidhje me vërtetimin e përvojës së ngjashme ka kërkuar që operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duhet të paraqesin “*furnizime të ngjashme me objektin e prokurimit në një vlerë jo më të vogël se 20 % fondit limit në një vlerë prej 558 790 (pesëqind e pesëdhjetë e tetë mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë) lekë, të ekzekutuar gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.* KPP gjykon të ndalet në një analizë të thelluar të dëshmimeve të eksperiencës së ngjashme të dorëzuar nga ana e operatori ekonomik Aerd Mahmutaj, parë kjo në rrafshin krahasimor me kërkesat teknike të autoritetit kontraktor, natyrës së procedurës së prokurimit objekt-ankimi. Kështu, referuar shtojcës 7 të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar shërbimet objekt - prokurimi dhe sasi të respektive të tyre. KPP gjykon, se në rastin konkret, kërkesa e autoritetit kontraktor referuar objektit të procedurës së prokurimit, lidhet me Shërbime të printimit dhe publikimit.

Në nenin 77 pika 4 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” , i ndryshuar është parashikuar se: *“4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”* KPP vlerëson se së pari, norma juridike duhet të interpretohet e më pas të gjykohet, kjo për të analizuar në thelb *ratio legis*, kuptimin e drejtë të saj. Kështu, ligjvënësi ka parashikuar diskrecionin e autoritetit kontraktor të kërimit të dëshmimeve për përvojën e mëparshme, me synim për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Pra, e drejta e dhënë nga ligji lidhet ngushtësisht me garantimin e autoritetit kontraktor, se operatori ekonomik disponon dëshmi të përvojës së mëparshme për të realizuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Gjithashtu, me akt nënligjor, diskrecioni i vendosur nga ligji është rregulluar edhe më tej, ku në rastin e kontratave për mallra, ligjvënësi në nenin 40, pika 4 të Vendimit nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, ka parashikuar, se ky kriter në rastin e përvojës së ngjashme të mëparshme të realizuar me entet publike, mund të përmbushet me dorëzimin e vërtetimeve të lëshuara nga enti publik ose me paraqitjen e faturës tatimore të shitjes, ku vërtetohet realizimi me sukses i një ose disa kontratave të ngjashme gjatë tre viteve të fundit nga data e njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të madhe se 40 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe në rastin e përvojës së ngjashme të mëparshme të realizuar me sektorin privat mund të përmbushet me dorëzimin e faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe furnizimet e realizuara, ku të vërtetohet realizimi i furnizimeve të ngjashme gjatë tre viteve të fundit nga data e njoftimit të kontratës, me një vlerë jo më të madhe se 40 % e vlerës së kontratës që prokurohet. Gjithashtu, në rregullat e prokurimit publik është përcaktuar se plotësimi i njërit prej dy kushteve e bën ofertën të kualifikueshme.

Duke iu kthyer kriterit, KPP konstaton, se kriteri i hartuar nga ana e autoritetit kontraktor është në përputhje me diskrecionin e dhënë nga ligji dhe akti nënligjor, si edhe afati i kërimit të dokumentacionit është brenda periudhës trevjeçare sikundër parashikohet edhe në këtë Vendim të Këshillit të Ministrave.

Lidhur me faktin nëse dokumentacioni i dorëzuar nga operatori ekonomik “SAKULI” SHPK, përmendur në pikën III.5.3. të këtij vendimi (Faturat Elektronike) plotësojnë apo jo kriterin kualifikues të furnizimeve të ngjashme, KPP do t’i analizojë në 3 (tre) komponentë kumulative dhe konkretisht komponenti i vlefshmërisë, komponenti i ngjashmërisë dhe komponenti i vlerës së realizuar. Për sa i përket vlefshmërisë së dokumentacionit të dorëzuar (Faturat Elektronike), Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se dokumentacioni është i vlefshëm për efekt të përmbushjes së kriterit kualifikues të sipërpërmendur dhe të përcaktuar në pikën 2.2.1 të dokumenteve të tenderit objekt-ankimi, pra është realizuar brenda afatit 3 (tre) vjeçar nga

data e publikimit të njoftimit të kontratës (25.03.2026). Faturat elektronike janë të periudhës 2024-2026

Lidhur me komponentin e ngjashmërisë, në analizë të thelluar dhe krahasimore të faturave tatimore të shitjes, të vlefshme, të dorëzuara nga ana e operatorit ekonomik “SAKULI” SHPK, KPP konstaton, se me anë të faturave tatimore të dorëzuara dëshmon, se ka kryer shërbime të natyrës së shërbimit objekt - prokurimi, sikurse është Shërbime të printimit dhe publikimit KPP konstaton, se nga shqyrtimi dhe verifikimi i të gjitha elementeve të këtyre faturave, rezulton, se këto fatura konsiderohen të ngjashme me objektin e prokurimit, pra operatori ekonomik ka arritur që të dorëzojë dëshmi që ka realizuar shërbime të ngjashme. Lidhur me komponentin e tretë, për sa i përket vlerës së faturave të paraqitura nga ana e operatorit ekonomik “SAKULI” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se vlera e kërkuar në kriterin kualifikues është realizuar, madje më shumë se ajo e kërkuar, me faturat e paraqitura. Sa më sipër, KPP vlerëson, se faturat tatimore të dorëzuara nga operatori ekonomik “SAKULI” SHPK plotësojnë të tre komponentët kumulativ në interpretim të kriterit kualifikues. Në këtë kuptim, KPP gjykon, se operatori ekonomik “SAKULI” SHPK me dokumentacionin e paraqitur, provon se ka kryer shërbime të ngjashme me objektin e prokurimit, duke plotësuar kështu kërkesën për kualifikim, për përvojë të suksesshme përcaktuar në pikën 2.1.1 të kriterëve të veçanta të kualifikimit..

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Inpress” SHPK nuk qëndron.

III.6. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Inpress” SHPK se: “....*OE Sakuli shpk., ditën dhe orën e hapjes së ofertave, ka pasur detyrim të papaguara dhe kontribute të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të papaguara. Për këtë arsye, kërkojmë nga KSHA e AK dhe KPP, që përpara marrjes së një vendimi të arsyetuar mbi këtë ankesë dhe për sa i përket kësaj pike, të kërkojnë zyrtarisht një informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.....*”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.6.1. Në shtojcën “Kriteret e përgjithshme të kualifikimit” pika 1 “dh” të dokumentave standarde të tenderit autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

Ofertuesi deklaron se:

dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 10

III.6.2. Në shtojcën, “Kriteret e Veçanta të kualifikimit” të dokumentave të tenderit, pikën 2.1.a është përcaktuar kriteret si më poshtë:

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10;

III.614.3. Në shtojcën 10 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pjesë e dokumenteve të tenderit, në Pjesën II, “Shkaqet e përjashtimit”, A: Deklaratë “Për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit”, ndër të tjera, parashikohet se:

Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së. Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

III.6.4. Në përmbushje të kriterit më sipër operatori ekonomik “SAKULI” SHPK ka paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik dokumentacionin si më poshtë:

- Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të operatorit ekonomik “SAKULI” SHPK;

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Vertetim për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore - Drejtoria Rajonale e Tatimeve Tirane Vertetim për pagesen e taksave vendore — Bashkia Vore

- Dokumentacioni fizik i operatorit ekonomik “SAKULI” SHPK dorëzuar pranë autoritetit kontraktor dhe ardhur me shkresën nr. 411/1 prot, datë 14.05.2026 protokolluar me tonën me nr. 1274/4 prot datë 15.05.2026, autoriteti kontraktor ndër të tjera ka dërguar edhe dokumentacionin e dorëzuar nga ana e operatorit ekonomik “SAKULI” SHPK, konkretisht edhe:

- Vërtetim Nr. T15371169, datë 26.03.2026 (Për Pagim Detyrimesh), nga ku vërtetohet se tatimpaguesi “SAKULI” SHPK nuk ka asnjë detyrim të papaguar deri më datë 26.03.2026.

- Vërtetim Nr. T153800594, datë 27.03.2026 (Për Kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore për tatimpaguesin E-Sig 02/a), nga ku vërtetohet se tatimpaguesi “SAKULI” SHPK nga të dhënat për kontributet të regjistruara në organin tatimor deri në datë 27.03.2026, që pasqyrojnë faktin e subjektit deri në datë 27.03.2026, rezultron se ky subjekt ka për të paguar 0 lekë detyrime, nga të cilat: Kontribute gjithsej 0 lekë. Kamatëvonesa për kontribute 0 lekë. Gjoha lidhur me kontributet 0 lekë.

II.64.5. Në nenin 77 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale. 182 Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiron vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”.

III.6.6. Në nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht :

“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, 183 formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik.”.

III.6.7. Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: *“3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”.*

III.6.8. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se:

“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarimin, si më poshtë vijon:

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

ç) operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;

d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;

e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;

h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);

i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;

j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;

k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi;

l) operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;

ll) operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.

6. Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i" dhe "j" të pikës 2 të Shtuar me VKM 498/2024 22 Shtuar me VKM 498/2024 30 këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Në procedurat e prokurimit me faza, ky dokumentacion i kërkohet të gjithë kandidatëve të kualifikuar në fazën e parë, përpara nisjes së afateve të ankimit. Ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë dokumentat provuese, të cilat duhet të jenë në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin. Për dokumentat e ofertës, të ngarkuara në sistemin e prokurimit elektronik, ofertuesi i kualifikuar i pari duhet t'i paraqesë këto dokumenta në origjinal ose të njehsuara me origjinalin. Gjithashtu, dokumentet provuese, që do të paraqiten për të provuar vetëdeklarimet

e bëra, duhet të paraqiten në origjinal ose të njësuara me origjinalin dhe të provojnë gjendjen faktike të ofertuesit në kohën e ofertimit të tij. Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike. Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj. Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

7. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.”.

III.6.9. Në pikën a) të nenit 11, të ligjit nr. 9163, datë 11.09.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar parashikohet se: *“Deklarimet e parashikuara në nenin 10 dhe pagesa e kontributeve bëhen në afatet e mëposhtme:*

a) nga personat juridikë, përjashtuar personat juridikë të regjistruar si tatimpagues të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël, brenda datës 20 të muajit pasardhës. Kur pronarët e personave juridikë ushtrojnë funksione drejtuese në shoqëri si administratorë ose çdo funksion tjetër trajtohen si çdo punëmarrës tjetër”.

III.6.10. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.6.11. Konkretisht, referuar kriterëve të përgjithshme të kualifikimit pikës dh) të shtojcës 8 ku përcaktohet se nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së, Komisioni konstaton se autoriteti kontraktor ka përcaktuar se, këto kërkesa do të përmbushen nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohet vetëm nga operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Referuar informacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor me nr. 4911/1 prot., datë 14.05.2026, protokolluar pranë Komisionit Prokurimit Publik me nr. 1274/4 prot, datë 15.05.2026, autoriteti kontraktor ndër të tjera ka dorëzuar dokumentacionin fizik të operatorit ekonomik “SAKULI” SHPK që vërteton përmbushjen e deklarimeve të bëra në Shtojcën 10 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit” të dorëzuar në dokumentacionin e ofertës. Nisur nga pretendimet e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues me arsyetimin se: “OE SAKULI shpk., ditën dhe orën e hapjes së ofertave, ka pasur detyrime tatimore të papaguara dhe kontribute të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të papaguara”. Komisioni konstaton se në përmbushje të pikës dh) të shtojcës 8 Kriterëve të Përgjithshme të Kualifikimit operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar dokumentacionin si vijon: - Vërtetim Nr. T15371169, datë 26.03.2026 (Për Pagim Detyrimesh), nga ku vërtetohet se tatimpaguesi “SAKULI” SHPK nuk ka asnjë detyrim të papaguar deri më datë 26.03.2026.

- Vërtetim Nr. T153800594, datë 27.03.2026 (Për Kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore për tatimpaguesin E-Sig 02/a), nga ku vërtetohet se tatimpaguesi “SAKULI” SHPK nga të dhënat për kontributet të regjistruara në organin tatimor deri në datë 27.03.2026, që pasqyrojnë faktin e subjektit deri në datë 27.03.2026, rezulton se ky subjekt ka për të paguar 0 lekë detyrime, nga të cilat: Kontribute gjithsej 0 lekë. Kamatëvonesa për kontribute 0 lekë. Gjoha lidhur me kontributet 0 lekë. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt - shqyrtimi, KPP vëren, se qëllimi i këtij kriteri është që nëpërmjet vetdeklarimeve dhe dokumentacionit të dorëzuar në autoritetin kontraktor pasi të shpallen fitues, të verifikohet, që operatorët ekonomikë nuk kanë detyrime të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të maturuara të pashlyera. Referuar sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “SAKULI” SHPK, në sistemin e prokurimeve elektronike, si dhe dokumentacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor konstaton, se ky i fundit, për të plotësuar kriterin e mësipërm ka paraqitur në SPE dhe dorëzuar fizikisht pranë KPP-së, Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, vërtetimet e sipërcituara të lëshuara nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë. Sa më sipër, nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit, dokumentacionit të dorëzuar në SPE dhe atij fizik pranë KPP-së nga operatorit ekonomik “SAKULI” SHPK, konstatohet se ky i fundit ka paraqitur dokumentacionin e nevojshëm për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit pikës dh) të shtojcës 8 ku përcaktohet se nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së, nga verifikimet e kryera Vërtetimit Nr. 15371169, datë 26.03.2026 dhe Vërtetim Nr. T15380059, datë 27.03.2026, rezulton se në datën e zhvillimit të procedurës së prokurimit objekt ankimi operatori ekonomik “SAKULI” SHPK nuk ka patur detyrime të kontributeve të

sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të maturuara të pashlyera dhe për më tepër, sipas përcaktimeve në nenin 11 të ligjit nr. 9163, datë 11.09.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar parashikohet se: “Deklarimet e parashikuara në nenin 10 dhe pagesa e kontributeve bëhen në afatet e mëposhtme: a) nga personat juridikë, përjashtuar personat juridikë të regjistruar si tatimpagues të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël, brenda datës 20 të muajit pasardhës. Kur pronarët e personave juridikë ushtrojnë funksione drejtuese në shoqëri si administratorë ose çdo funksion tjetër trajtohen si çdo punëmarrës tjetër”. Në rastin konkret operatori ekonomik “SAKULI” SHPK rezulton se nuk ka patur detyrime të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të pashlyera në datë 26.03.2026, duke përmbushur kriterin kualifikues të përcaktuar në pikën/dh “Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes/ Kualifikimit” të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Inpress” SHPK nuk qëndron.

III.7. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “FILARA” SHPK se “Operatorët Ekonomikë “ALBDESIGN PSP” shpk “UNIVERTS PROMOTIONS” shpk. nuk arrijnë të plotësojnë Kriteret e Përgjithshme të Kualifikimit....

-se sipas disa konstatimeve mendojmë se nuk janë respektuar mardhëniet e punësimit sipas legjislacionit në fuqi,

-Përsa I përket pikës 2.2.2. të Kriteve të Vecanta për Kualifikim kemi bindje që këto dy Operatorë Ekonomikë megjithëse mund të disponojnë një Disenjator nuk e kanë në përputhje me Kërkesat e Autoritetit Kontraktor pasi nuk zotërojnë Eksperiencë të pakten një Vjecare

- përsa I përket numrit të punësuarve për muajin e fundit sipas përcaktimeve të pikës 2.2.3 , kemi bindjet tona se dy Operatoret Ekonomikë nuk e plotësojnë këtë kriter pasi nuk kanë e disponojnë këtë numër punonjësish për muajin e fundit që korespondon me Shkurt 2026

- dhe mbi të gjitha ende mendojmë se ende nuk ka shlyer detyrimeve e Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetsore përsa I përket muajit të fundit Shkurt 2026 përpara datës së Vetdeklarimit.

- kemi bindje se Operatorët Ekonomikë “ALBDESIGN PSP” shpk dhe “UNIVERS PROMOTIONS” shpk. nuk plotësojnë Kriteret e vendosura në pikën 2.2.4 Konkretisht të Printerit Dixhital dhe Makineri Plastifikimi....

Dhe për të cilat kërkon Verifikimin e Dokumentacionit Provues sipas Deklarimeve në Formularin e Vetdeklarimit për Operatorëve Ekonomikë “ALBDESIGN PSP” dhe “UNIVERTS PROMOTIONS” shpk, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.7.1. Në shtojcën “Formular i Kriteve të Përzgjedhjes/Kualifikimit”, autoriteti kontraktor ka kërkuar;

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;*
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);*
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;*
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;*
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;*
dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.*
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;*
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;*
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;*
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.*
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfutur fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.*

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.*
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.*

III.7.2. Në pikën 2. Kriteret e veçanta të kualifikimit, pika 1.a, të shtojcës “Formular i Krieteve të Përzgjedhjes/Kualifikimit”, autoriteti kontraktor ka kërkuar;

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10;

III.7.3. Në pikën 2. Kriteret e veçanta të kualifikimit, pika 2.2. “**Aftësitë teknike dhe profesionale**”, të shtojcës “Formular i Krieteve të Përzgjedhjes/Kualifikimit”, autoriteti kontraktor ndër të tjera ka kërkuar

2.2.2 Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë:

- a. Ofertuesi duhet të ketë në stafin e tij një dizenjator, me eksperience të pakten 1 vjetare në fushën e dizenjimit, të punësuar me kohë të plote dhe të përfshirë në listpagesa për muajin e fundit të deklaruar sipas legjislacionit në fuqi.***

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

-Kontraten e punës

-CV

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 10 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese, të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”

dhe “j”, të pikës 2, të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

2.2.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kësaj kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej **minimalisht 5 persona** dokumentuar kjo me Vertetimin e pageses se sigurimeve shoqerore dhe shendetesore nga administrata tatimore dhe listpagesat e Kontributeve te Sigurimeve Shoqerore, Shendetesore dhe Tatimit mbi te Ardhurat nga Punesimi, **për muajin e fundit të deklaruar sipas legjislacionit në fuqi.**

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 10 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “ Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese, të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j”, të pikës 2, të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

2.2.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

-Makineri shtypi

-Printer dixhital

-Pajisje laminuese

*Sqarim: Me pajisje laminuese nenkuptohet makineria per plastifikim ose makineria per ngjitje.

Per pajisjet e mesiperme ofertuesi duhet te paraqese: foto per secilen nga pajisjet shoqeruar me dokumentacionin që vërteton pronësinë ose posedimin mbi pajisjet e mesiperme (psh. fatura blerje,deklaratë zhdoganimi, kontratë qeraje, kontratë dhurimi dhe cdo formë tjetër të parashikuar nga legjislacioni në fuqi për disponimin/posedimin e pasurive të luajtshme)

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 10 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “ Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese, të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j”, të pikës 2, të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

III.7.4 . Në shtojcën 10 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, të dokumenteve standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, , autoriteti kontraktor ka përcaktuar si vijon:

Shtojca 10.

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	----- --
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	----- -
E-mail:	----- -----

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- **Informacione për nënkontraktorin**

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT –i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

• Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata		
<p>Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.</p> <p><i>Sqarimenëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>		
<p>Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>		
<p>Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:</p>		
Emri	Mbiemri	NID (Numri personal i identifikimit)

nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori Ekonomik nuk ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate.

Sqarime nëse vlerësohet nevojshme _____

Operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.

Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta

për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

B: DEKLARATA “Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura”

Në cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, Deklaroj Se:

Jam në dijeni të pasojave që vinë ndaj meje lidhur me këtë Deklaratë, në respektim të ligjit nr. 9121/2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.

Kam përgatitur ofertën në mënyrë të pavarur, pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër².

Në veçanti, pa kufizuar si më lart, nuk kam pasur kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent me qëllim cënimin e konkurrencën, në lidhje me:

çmimet;
metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;
qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,
paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.

Nuk kam pasur marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent, me qëllim cënimin e konkurrencës, në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë.

Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t’u bëhen të njohura, me qëllim cënimin e konkurrencës, në çdo mënyrë qoftë, konkurrentëve të tjerë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj.

C: DEKLARATA “Mbi Konfliktin e Interesit”

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon:
Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.

² Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, fjala “konkurrentë” nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që: a) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor; b) është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.

Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë:

- Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministrat, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtorit i Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

- Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kreut III, seksionit 2 të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, siç përcaktohet këtu të zbatohet vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe territorit të institucionit dhe juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varësie.

Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin ku zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafët 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin, d.m.th. **bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit dhe bashkëjetuesit.**

Unë jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive, si dhe Ligji Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik".

Në përputhje me to, unë deklaroj këtu se asnjë zyrtar publik, siç përcaktohet në Kapitullin III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk ka ndonjë interes privat, direkt ose indirekt, me personin juridik që unë përfaqësoj këtu.

D: DEKLARATA "Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës"

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Operatori ekonomik _____ garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.
- Operatori ekonomik _____ lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.
- Operatori ekonomik _____ nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit

A: DEKLARATË “Në përputhje me specifikimet teknike dhe grafikun e realizimit të objektit të kontratës”

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojnë të gjitha specifikimet teknike, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë (nëse kërkohet nga Autoriteti Kontraktor), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me Listën e mallrave dhe grafikun e lëvrimit të përcaktuar nga Autoriteti kontraktor.	Po [] Jo []

B: DEKLARATË

Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se: Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.	<u>Punonjës</u> Po [] Jo [] Nëse, po, numri i punonjësve: <hr/> Profili i punonjësve <hr/> <u>Makineri e mjete</u> Po [] Jo [] Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete: <hr/>

Emri, Mbiemri _____
Firma _____
Vula _____
Data e dorëzimit të deklaratës _____

Ju lutemi sigurohuni që:

- **Secili pjesëmarrës i renditur në një bashkim operatorësh ekonomikë të paraqesë një Formular të veçantë të Vetëdeklarimit.**
- **Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, një Formular i veçantë i Vetëdeklarimit duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.**
- **Çdo vetdeklarim i pavërtetë/pasaktë nga ana e operatorëve ekonomikë jo vetëm që përbën shkak për skualifikimin nga procedura konkrete, por përbën shkak dhe për përjashtimin e tyre nga e drejta për të fituar kontrata publike deri në 3 vjet, sipas parashikimeve të ligjit për prokurimin publik.**
- **Operatorët ekonomikë që ofertojnë në procedurat e prokurimit të vetdeklarojnë në çdo rast informacionin e saktë që i korrespondon gjendjes së tyre faktike.**

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik për sa më sipër.

- Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike.
- Në procedurat e prokurimit me faza, ky dokumentacion i kërkohet të gjithë kandidatëve të kualifikuar në fazën e parë, përpara nisjes së afateve të ankimit.
- Ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, për dokumentat e ofertës të ngarkuara në Sistemin e Prokurimit Elektronik duhet të dorëzojë dokumentat provuese, të cilat duhet të jenë në origjinal ose në kopje të njehsuara. Ndërsa, dokumentet provuese, që do të paraqiten për të provuar vetëdeklarimet e bëra, duhet të paraqiten në origjinal ose të njehsuara me origjinalin dhe të provojnë gjendjen faktike të ofertuesit në kohën e ofertimit të tij.
- Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

III.7.5. Nga verifikimi i dokumentacinit të dorëzuar në sistemin e prokurimeve elektronike në përmbushje të kritereve të mësipërme operatori ekonomik “Albdisagne” SHPK dhe “UNIVERS PROMOTION” SHPK ka dorëzuar:

- Shtojca 10 Formualri Përmbledhës Vetëdeklarimit i plotësuar në të gjitha fushat i firmosur dhe vulosur.

III.7.6. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se:

Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

Në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se *1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.*

Në nenin 77, pika 1 dhe 3 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

III.7.7. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se:

“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarimin, si më poshtë vijon:

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së; ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;

d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;

e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi; f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi; gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;

h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);

i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;

j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti; k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. *Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.*
5. *Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.*
6. *Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të V, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin. Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike. Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.*
7. *Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t’i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.”*

III.7.8. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim, ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.7.9. Në rastin konkret referuar pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues “FILARA” SHPK, Komisioni konstaton, se operatorët ekonomikë “ALBDESIGNE PSP” SHPK dhe “UNIVERS PROMOTIO” SHPK kanë ngarkuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik, Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit që autoriteti kontraktor ka përcaktuar në dokumentat standarde të tenderit objekt prokurimi. Në këtë formular, vërehet se operatorët ekonomikë “ALBDESIGNE PSP” SHPK dhe “UNIVERS PROMOTIO” SHPK kanë dhënë informacion për plotësimin e të gjithë rubrikave të mësipërme që lidhen me plotësimin e kërkesave të përgjithshme të kualifikimit duke përcaktuar dokumentin konkret, autoritetin lëshues apo dokumentin konkret të institucionit nga janë siguruar të dhënat duke dhënë indicie për institucionin apo dokumentacionin konkret mbi bazën e cilit do të kryhet verifikimi në fazën tjetër të vlerësimit të dokumentacionit të dorëzuar në autoritet përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit. Referuar sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatorët ekonomikë “ALBDESIGNE PSP” SHPK dhe “UNIVERS PROMOTIO” SHPK plotësojnë kriteret e përgjithshme të kualifikimit sipas kërkesave të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, pjesë e dokumenteve të tenderit, duke dhënë të dhënat e nevojshme për rubrikat e cituara më sipër në këtë vendim sic ky formular parashikon. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kriteret kualifikuese dhe kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me kërkesat e dokumenteve të tenderit dhe legjislacionin në fuqi. KPP gjykon se kriteret e veçanta për kualifikim kanë si synim kryesor që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Sa më lart KPP gjykon se operatorët ekonomikë “ALBDESIGNE PSP” SHPK dhe “UNIVERS PROMOTIO” SHPK ka plotësuar të gjitha rubrikat e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit lidhur me plotësimin e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator si dhe me dokumentet standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi. Nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, për verifikimin e këtyre dokumentacionit të deklaruar nga këta operator ekonomi Komisioni konstaton se operatorët ekonomikë “ALBDESIGNE PSP” SHPK dhe “UNIVERS PROMOTIO” SHPK nuk janë në kushtet që të zbatohen detyrimet nenit 26 pika 6 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, për të paraqitur pranë autoritetit kontraktor dokumentet provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatorët ekonomikë “ALBDESIGNE PSP” SHPK dhe “UNIVERS PROMOTIO” SHPK me dokumentacionin e dorëzuar në SPE (formularin përmbledhës të vetëdeklarimit), i përmush kërkesat e autoritetit kontraktor. Sa më lart KPP gjykon se operatorët ekonomikë “ALBDESIGNE PSP” SHPK dhe “UNIVERS PROMOTIO” SHPK kanë plotësuar Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 10 të

dokumentave standarte të tenderit në të gjitha rubrikat lidhur me plotësimin e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit duke dhënë informacionin që ky formular kërkon.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “FILARA” SHPK nuk qëndron.

III.7.9.1. Lidhur me pretendimet e tjerat të operatorit ekonomik ankimues “FILARA” SHPK mbi verifikimin e dokumentacionit të operatorëve ekonomikë “ALBDESIGNE PSP” SHPK dhe “UNIVERS PROMOTIO” SHPK mbi disponimin e fuqisë punëtore, disponimin në stafin e tij të njëdizanji si dhe mbi disponimin e makinerive, nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit konstatohet, se autoriteti kontraktor në pikën 2.2 “Aftësitë teknike dhe profesionale” ka kërkuar ndër të tjera: 2.2.2- *Ofertuesi duhet të ketë në stafin e tij një dizenjator, me eksperience të pakten 1 vjecare në fushën e dizenjimit, të punësuar me kohë të plote dhe të përfshirë në listpagesa për muajin e fundit të deklaruar sipas legjislacionit në fuqi. Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin: -Kontraten e punës - CV.”. Në pikën 2.2.3 ka kërkuar që Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kësaj kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht 5 persona dokumentuar kjo me Vertetimin e pageses së sigurimeve shoqërore dhe shendetesore nga administrata tatimore dhe listpagesat e Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore, Shendetesore dhe Tatimit mbi të Ardhurat nga Punësimi, për muajin e fundit të deklaruar sipas legjislacionit në fuqi” dhe në pikën 2.2.4 ka kërkuar Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme: -Makineri shtypi -Printer dixhital -Pajisje laminuese *Sqarim: Me pajisje laminuese nënkuptohet makineria për plastifikim ose makineria për ngjitje. Për pajisjet e mesiperme ofertuesi duhet të paraqesë: foto për secilin nga pajisjet shoqëruar me dokumentacionin që vërteton pronësinë ose posedimin mbi pajisjet e mesiperme (psh. fatura blerje, deklaratë zhdoganimi, kontratë qeraje, kontratë dhurimi dhe cdo formë tjetër të parashikuar nga legjislacioni në fuqi për disponimin/posedimin e pasurive të luajtshme)*

Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatorët ekonomikë, në përmbushje të kriterit të sipërpërmendur, konkretisht Formularët Përmbledhës të Vetëdeklarimit, konstatohet, se në lidhje me kërkesën për fuqinë punëtore, punonjësin dizenjator dhe makineritë, të kërkuar në pikën 2.2.2.; 2.23 dhe 2.2.4 të kriterëve të veçanata të kualifikimit, të deklaruar në Pjesën III: Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit , B: DEKLARATË Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme se ka punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërteton këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor, e më konkretisht operatori ekonomik “ALBDESIGNE PSP” SHPK ka deklaruar: mesatarisht 35 punonjës punonjës, nga të cilët: 2 punonjës të profilit Designer grafik znj.Enkeleda Hasimllari , dhe z.Rubin Laja.

Për mjetet ka deklaruar se disponon pajisjet e mëposhtme: -Makineri shtypi- me format max 70x100 cm me 5 ngjyra , fatura nr .29 -Printer dixhital — printer dixhital fature nr 244 si edhe printeraUV / plottera të ndryshme për printime banner dhe adezive sipas faturave 270212737,

fatures nr 32 etj -Pajisje laminuese, sipas faturave tatimore nr 31 dhe nr 26. Vertetuar me ane te faturave tatimore te blerjes bashkangjitur kesaj deklarate.

Ndërsa operatori ekonomik “UNIVERS PROMOTIO” SHPK ka deklaruar: mesatarisht 44 punonjes, nga të cilët: 1 punonjës të profilit z.Selma Alija K25415064Ë .Për mjetët ka deklaruar se disponon pajisjet e mëposhtine: - 1. Makineri plastifikimi – Data e blerjes 05/10/2015, Nr.fature 0016860 2.Makineri printimi dixhital DP8700XL – Data e blerjes 15/12/2017, Nr.fature 96125, 3. Makineri shtypi KM AccPress C14000 – Data e blerjes 26/05/2025, Nr.fature 2025- 0026.

Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pika 1 dhe gërma “h” e pikës 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla. 2.Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarinimin, si më poshtë vijon: h) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti

Gjithashtu, nga një korrespondencë e mëparshme midis Komisionit të Prokurimit Publik dhe Agjencisë së Prokurimit Publik, me shkresën nr. 319/1 prot., datë 19.01.2022 protokolluar me tonën nr. 2472/5 prot., 21.01.2022, Agjencia Prokurimit Publik njofton Komisionin e Prokurimit Publik ndër të tjera se: [.] Kriteri për kualifikim mbi disponimin e punonjësve dhe mjeteve duhet të përmbushet, nëpërmjet paraqitjes së Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit nga operatori ekonomik, sipas shtojcës së DST. Qëllimi i paraqitjes së deklaratës “Mbi disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme” në këtë shtojcë, është garantimi i ekzekutimit të kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, pra që operatori ekonomik ka stafin teknik sipas të dhënave të kërkuara. Referuar sa më sipër, plotësimi i kësaj deklarate do të jetë në lidhje me numrin e punonjësve, nëse do të jetë kërkuar, dhe profilin e tyre, sipas kërkesave specifike të vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit të një procedure prokurimi [].

Nisur nga sa parashtuar më sipër, korrespondencës së kryer me Agjencinë e Prokurimit Publik, të dhënave të deklaruara nga operatori ekonomik ankimues në Formularin e vetdeklarimit në pjesën III: “Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit, pika B Deklaratë “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e shërbimeve objekt - kontrate”, Komisioni gjykon, se punonjësit e sipërpërmendur të deklaruar të operatorit ekonomik ankimues, kanë të evidentuar të dhënat, si dhe profilin respektiv të kërkuar sipas pikës 2.2.2, 2.2.3.dhe 2.2.4 të kriterëve të kualifikimit, deklaratë kjo e cila i shërben autoritetit kontraktor për vlerësimin e përmbushjes së kriterëve të kualifikimit për këtë fazë të vlerësimit të procedurës së prokurimit. Komisioni gjykon, se autoriteti kontraktor në fazën e vlerësimit procedural në të cilën ndodhet aktualisht procedura e prokurimit objekt-ankimi, për përmbushjen e kriterëve të kualifikimit, duhet t’i referohet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, dhe vetëm përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat

“a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26, të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Në këtë kuadër, Komisioni gjykon, se deklarimi i punonjësve , punonjësit të profilit sipas kërkesave të pikës 2.2.3 dhe disponimit të mjeteve sipas kërkesave të pikës 2.2.4 . të kriterëve të kualifikimit në seksionin përkatës të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, në stadin në të cilin ndodhet procedura e vlerësimit, sjell përmbushjen e kriterëve të kualifikimit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit. Në përfundim të argumentimit të mësipërm, Komisioni arrin në konkluzionin, se dokumentacioni i paraqitur nga operatorët ekonomikë “ALBDESIGNE PSP” SHPK dhe “UNIVERS PROMOTIO” SHPK në procedurën e prokurimit në këtë fazë, e plotëson kërkesën e autoritetit kontraktor dhe si i tillë konsiderohet i vlefshëm.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “FILARA” SHPK nuk qëndron.

III.8. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “FILARA” SHPK se *“Operatorët Ekonomikë “ALBDESIGN PSP” shpk “UNIVERTS PROMOTIONS” SHPK. nga informacionet dhe njohuritë që disponojmë mbi tregun përkatës të aktivitetit, na rezulton se këta operatorë nuk kanë realizuar punë të mëparshme të ngjashme, në përputhje me natyrën, kompleksitetin dhe kualifikimin e kërkuar në dokumentet e tenderit”* , Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.8.1. Në shtojcën “Formulari i Kriterëve të Përzgjedhjes/Kualifikimit” pika 2.2.1 “Aftësitë teknike dhe profesionale” të dokumentave të tenderit në dokumentet standarde të tenderit në procedurën e prokurimit objekt - ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

“2.2.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes te njoftimit te kontrates, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së perlllogaritur te kontrates qe prokurohet .

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) *për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.*

b) *për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.*

-Per kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë gjithashtu edhe Kontraten e Bashkimit te operatoreve ekonomikë.

-Per kontratat e realizuara si Nënkontraktor, Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë gjithashtu edhe Kontratën baze ndermjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor si dhe Miratimin zyrtar si nenkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.”

III.8.2. Në shtojcën 8, “Terma e Referncës” në dokumentet standarde të tenderit në procedurën e prokurimit objekt - ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon:

” Sherbime te printimit dhe publikimit,materiale promocionale”

N r.	Emertimi	Sasi a	Njës ia	Pershkrimi
1	Karta për pensionistët	500	copë	Materiali PVC i posacem per ID, me fotografi. Printim 4 ngjyrësh . Nivel sigurie relief ne vende te ndryshme. Printimi i kartave do te behet sipas sasise dhe kerkesave i shtrire ne kohe. Operatori ekonomik eshte pergjegjes per dzenjimin dhe pergatitjen e materialit.Operatori ekonomik duhet te paraqitet prane autoritetit kontraktor cdo date 30 te muajit te terheqe informacionet per prodhimin e Kartes te pensionistit sipas kerkesave mujore te qytetareve.Peseritja e Kartave per gabime ne te dhenat eshte pergjegjesi e operatorit ekonomik.
2	Baner	260	m ²	Baner 600gr/m2, printim nga nje ane CMYK, i pajisur ne rastet kur nevojitet me unaza metalike ose mekanizem. Ideimi, dizenjimi dhe printimi i banerit per aktivitetet e bashkise, permasat do te jene sipas kerkeses te autoriteti kontrakues. Psh. 100 cmx200 cm, 150cm x300 cm, 300cmx200 cm, 200cmx400cm, 300 cmx600cm, Banerat nuk duhen te jene me bashkime.Operatori duhet te mbuloje edhe montimin ne vend te banerit sipas kerkeses te AK.
3	Roll up baner	2	copë	Baner roll up me mekanizem me permasa 220cm x 100cm, e printuar ne film PVC me sfond te zi nga mbrapa, i dizenuar sipas kerkeses se AK për aktivitete te ndryshme te realizuara gjate vitit.
4	Çertifikata format A4	100	copë	Çertifikata format A4 e dizenuar dhe e shtypur ne CMYK sipas listes se vendosur ne dispozicion nga menaxheri i projektit. Leter 400 gsm.
5	Adeziv	80	m ²	Adeziv per kushte te jashtme, printim CMYK, ngjitja do te behet nga operatori ekonomik. Dizenjimi do te jete i ndryshem per sasi dhe modele te ndryshme ne varesi te kerkeses se AK dhe kostoja do te merret persiper nga operatori ekonomik fitues. Operatori fitues duhet te mbuloje dhe montimin ne vend te adezivit sipas kerkeses se AK
6	Fletëpalosje njëfletëshe	1,700	copë	Flete palosje me permasa 10cmx21cm per aktivitetet e Bashkise, me modele te ndryshme te pershtatura sipas aktiviteteve. Leter 350gsm,me printim digital,leter me shkelqim printim ne te dyja anet. Dizenjimi do te jete i ndryshem per sasi dhe modele te ndryshme ne varesi te kerkese te AK dhe kostoja do te merret persiper nga operatori ekonomik fitues. Kerkohet te dorezohet model i printuar para prodhimit nga operatori ekonomik.

7	Fletëpalosje dyfletëshe	700	copë	Fletëpalosje dy fletëshe me format A4 me përmasa 10cm me 21 cm, per aktivitetet e Bashkise, me modele te ndryshme te pershtatura sipas aktiviteve. Leter 350gsm,me printim digital,leter me shkelqim printim ne te dyja anet. Dizenjimi do te jete ne varesi te kerkese te AK dhe kostoja do te merret persiper nga operatori ekonomik fitues. Kerkohet te dorezohet model i printuar para prodhimit nga operatori ekonomik.
8	Ftesa	1,700	copë	Letër 350gsm me printim dixhital, me shkëlqim ose jo, dizanji dhe permasat do të përcaktohet në varësi të kërkeses të autoritetit kontraktor
9	Broshurë triplete me palosje për promovimin e turizmit	1,900	copë	Trashesia e letres: 350 gr/m2. Lloji i shtypjes: Printim nga te dyja anët. Ana e perparme e kartolines do te kete foto qe perzgjidhet nga AK cila do te jete do jete printim mat pa shkelqim, e dizenuar sipas kerkeses së AK. Menyra e shtypjes: Permasat: 45cm x15cm.
10	City Light (180cm x 120cm)	100	copë	Leter 180 gr/m2 ,permasat 180x120, ngjitja do te behet nga operatori ekonomik,printim CMYK. Dizenjimi do te jete i ndryshem per sasi dhe modele te ndryshme ne varesi te kerkese te AK dhe kostoja do te merret persiper nga operatori ekonomik fitues.
11	Harta të Korçës	6,000	copë	Hartë e qytetit me palosje me informacion dhe legjendë rreth atraksioneve turistike dhe kulturore në qytet sipas orientimeve të Autoritetit Kontraktor. Formatit 50cm X 70cm, Leter mat 170gr, e palosur ne 8 pjese.
12	Bexhe staff	170	copë	Lloji i letres Karton 15cmx 10cm printim digital i plastifikuar nga te dyja anet sipas kerkeses se AK. Bexhe te jete e vendosur ne qafore 45cm cope te loguar, gjatesia me trashesi 4 cm sipas kerkeses se AK
13	Varëse çelësash me logo	100	copë	Varëse çelësash me ngjyra të ndryshme font pastel dhe stampim të logos Korça, the Heartland
14	Stilolapsa me logo	210	copë	Stilolaps me ngjyrë të zezë dhe stampim të logos Korça, the Heartland dhe stilolapsa të stampuar me logon e aktiviteve, e cila do të jetë në varësi të kërkesës së AK
15	Shall i stampuar me logo	25	copë	Shall material najlon me përmasa 30x100 cm të stampuara me logo ose mbishkrim ngjyrë portokalli dhe ngjyre tjetere, ne varesi të kërkesës së AK.
16	USB me kuti druri të gdhendur me logo	50	copë	USB flash drive i zakonshëm me kapacitet të 16GB, e vendosur në kuti druri (bambu) me gdhendje dhe stampim logo Korca, the Heartland
17	Bluza (Tshirt) me mbishkrim dhe logo të aktiviteve full printed	30	copë	Bluza me minge te shkurtra per femra dhe meshkuj, me qepje te dyfishte tek jaka, materiali pambuk dhe me qendrueshmeri ndaj larjes, me masa te ndryshme, e loguar me me logo Korca, dhe BE te kerkuar sipas udhezimeve te AK. Bluzat duhet të jenë të bardha
18	Bluza te stampuara	100	copë	Bluza me minge te shkurtra per femra dhe meshkuj, me qepje te dyfishte tek jaka, materiali pambuk dhe me qendrueshmeri ndaj larjes, me masa te ndryshme, e loguar me imazhin/ grafiken (e gomuar ose e njetrajtshme me bluzen) printim 3D 1PC te kerkuar sipas udhezimeve te AK.

				Ngjyrat e stampimit 3D mund të jenë të ndryshme në varësi të cilësimeve të kompjuterit dhe monitorimit nga organizatorët
19	Çanta beze full printed ekologjike me logo të aktivitetit	50	copë	Çanta materiali beze dhe poliestër me përmasa 50*50cm, e stampuar me logon dhe emrin e aktivitetit, stampim 4-ngjyrësh. Dizenjimi do të jetë në varësi të kërkesës së AK
20	Shirit portokalli në formë fjongo	100	copë	<p>Fjongo simbolike e vogël për ndërgjegjësim kundër dhunës në familje, e destinuar për t'u vendosur në bluzë, xhakët ose veshje të tjera përmes karficës metalike në pjesën e pasme. Produkti përdoret gjatë fushatave sensibilizuese, aktiviteteve publike, eventeve institucionale dhe shpërndarjes në komunitet.</p> <p>Fjongoja duhet të jetë e realizuar nga shirit sateni ose poliester cilësor, me sipërfaqe të lëmuar dhe me shkëlqim të lehtë. Gjerësia e shiritit rekomandohet 1–1.5 cm, ndërsa gjatësia para formimit 8–10 cm, duke krijuar një fjongo të formuar me lartësi rreth 4–5 cm. Forma duhet të jetë klasike sensibilizuese me pjesën e poshtme të prerë drejt ose në formë V.</p> <p>Ngjyra duhet të jetë portokalli, si simbol ndërkombëtar kundër dhunës në familje, me tonalitet të qëndrueshëm dhe rezistent ndaj zbehjes. Në pjesën e pasme duhet të vendoset karficë metalike e vogël (tip gjilpërë me kapëse sigurie), me gjatësi rreth 2 cm, e fiksuar fort me qepje ose ngjitje industriale cilësore, në mënyrë që të mos shkëputet gjatë përdorimit normal. Karficia duhet të jetë funksionale, e sigurt dhe pa elementë të mprehtë të ekspozuar përveç gjilpërës standarde.</p>
21	Fjongo portokalli (Forex 3mm + Adeziv)	22	copë	<p>Produkti duhet të realizohet në formën standarde të simbolit të sensibilizimit, sipas konfigurimit grafik klasik të përbërë nga dy shirita që kryqëzohen në pjesën qendrore të sipërme dhe përfundojnë me dy skaje të zgjatura në pjesën e poshtme. Elementi duhet të ruajë simetri të plotë vizuale, proporcione të balancuara dhe lakime të rregullta, pa deformime apo devijime nga forma e njohur e simbolit. Laku qendror duhet të jetë i qartë dhe i harmonizuar me trashësinë e brezit, ndërsa prerjet në pjesën e poshtme duhet të jenë të realizuara në mënyrë të njëtrajtshme dhe estetike.</p> <p>Materiali i përdorur duhet të jetë forex (PVC i ngurtë) me trashësi 3 mm, i përshtatshëm për përdorim në ambiente të jashtme dhe rezistent ndaj kushteve atmosferike. Materiali duhet të garantojë qëndrueshmëri strukturore, mosdeformim gjatë ekspozimit në rrezatim diellor, lagështirë dhe ndryshime të temperaturës.</p> <p>Elementi duhet të ketë këto përmasa: lartësi totale 75 cm ±5 cm, gjerësi maksimale 40 cm ±5 cm dhe trashësi të brezit 13 cm ±2 cm, duke respektuar proporcionalitetin klasik të simbolit dhe balancën estetike të tij.</p> <p>Ngjyra e elementit duhet të jetë portokalli. Realizimi i ngjyrës/printimit duhet të kryhet me teknologji UV direkt mbi material ose me vinil cilësor të përshtatshëm për ambiente të jashtme, duke garantuar qëndrueshmëri të ngjyrës dhe rezistencë ndaj faktorëve atmosferikë,</p>

				<p>përfshirë rrezet UV dhe lagështirën.</p> <p>Përpunimi duhet të realizohet me prerje CNC sipas konturit të formës së fjongos, me sipërfaqe të lëmuar dhe pa cepa të mprehtë. Produkti duhet të sigurojë rezistencë minimale prej 30 (tridhjetë) ditësh në ambient të jashtëm pa dëmtime strukturore apo zbehje të konsiderueshme të ngjyrës.</p> <p>Çdo element duhet të dorëzohet i pajisur me elementet e montimit të përfshira në çmim, konkretisht me dy vrima të përforcuara në pjesën e sipërme për fiksim dhe 2–3 fasheta plastike rezistente ndaj rrezeve UV (minimumi 4.8 mm gjerësi), ose alternativisht me sistem adeziv industrial (shirit dopio-faqësh industrial tip 3M VHB).</p>
22	Spila me logo	76	copë	Spila me logo, me stampim me diameter 4 cm. Modeli i spilës dhe logimi i saj do të jetë në varësi të kërkesës së AK, të përcaktuar sipas aktiviteteve, që do të organizohen
23	Kartvizita	200	copë	Kartvizita printim nga te dy anët trashesia e letres: 400 gr/m2 sipas udhëzimit të AK.
24	Kartolinat e fundvitit	4,800	copë	Trashesia e letres: 350 gr/m2. Lloji I shtypjes: Ana e perparme e kartolines do te kete foto qe perzgjidhet nga AK cila do te jete me laminim dhe logo e Bashkise do jete me llakim parcial lluster. Menyra e shtypjes: Nga te dyja anet. Permasat : 22cmx17.5cm. Kartolinat do pajisen me zarfa te personalizuar me emer dhe adrese. Dizenjimi do te jete I ndryshem per sasi dhe modele te ndryshme ne varesi te kerkeses te AK dhe kostoja do te merret persiper nga operatori ekonomik fitues.
25	Buletin informues për punën e Këshillit Bashkiak	200	copë	Broshurë informuese që përmban të gjitha aktivitetet e zhvilluara nga Këshilli Bashkiak Korçë të shoqëruara me foto, Formati 21 x 21, leter ngjyre e bardhe cilesore, 30-50 faqe te printuara gjithsej. Printim i fleteve te brendshme mat 200 gsm. me ngjyra CMYK, Kopertina 350 g msq, plastifikuar mat ose luster. Kapja: Me qepje dhe me ngjitje. Dizenjimi sipas kërkesës së AK.
26	Bllloqe shënimi (Java e Evropes)	300	copë	Blllok shenimesh me format A5, me ngjitje spiraled he me flete te bardha brenda (jo te ndritshme), me kapak te trashe kartoni nje ngjyresh me logon e bashkise dhe logon e BE, si dhe me shkrimin Java e Evropes, Bashkia Korçë

Kontraktori duhet te realizojë shërbimin e kërkuar dhe dorëzimin e materialeve ne perputhje me specifikimet teknike brenda 5 diteve nga kërkesa e dërguar (me shkrim ose nepermjet emailit) nga Autoriteti Kontraktor. Materialet te dorezohen nga kontraktori ne bashkine korce, brenda orarit zyrtar te punes.

Ne rastin e materialeve qe kerkojne dizenjim nga kontraktori, kontraktori duhet te marre miratimin e Autoritetit Kontraktor

per dizenjimin perpara se te beje printimin e materialeve

Ne rastin e materialeve qe kerkojne dizenjim, Operatori ekonomik DUHE'T' te dorezoje krahas kopjeve te printuara dhe variantin elektronik te perpunueshem

te cdo materiali prane Autoritetit Kontraktor

Cdo produkt i ideuar dhe prodhuar per aktivitetet, festat apo si material promocional eshte pronesi e Bashkise Korce. Shperndarja e ketyre materialeve apo dhe shumefishimi i tyre pa lejen e Bashkise eshte rreptesisht i ndaluar.

III.8.3. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se operatori ekonomik “ALBDESIGN PSP” SHPK, për përmbushjen të kriterit të mësipërm, ka paraqitur dokumentacionin punime_te_ngjashme PDF në të cilën janë faturat e fiskalizuar si më poshtë vijon:

- Fature nr.266/2024 me vlere 110 000 lekë pa tvsh
- Fature nr.369/2024 me vlere 491 648.64 lekë pa tvsh
- Fature nr.535/2024 me vlere 704 829 lekë pa tvsh
- Fature nr.552/2024 me vlere 5400 000 lekë pa tvsh
- Fature nr.633/2025 me vlere 315 800 lekë pa tvsh
- Fature nr.788/2025 me vlere 48 400 lekë pa tvsh
- Fature nr.145/2025 me vlere 40 000 lekë pa tvsh
- Fature nr.446/2024 me vlere 1 283 110 lekë pa tvsh
- Fature nr.498/2024 me vlere 1 064 000 lekë pa tvsh
- Fature nr.1195/2024 me vlere 2 488 333.33 lekë pa tvsh
- Fature nr.11201/2024 me vlere 217 684.67 lekë pa tvsh
- Fature nr.1202/2024 me vlere 1 768 983.33 lekë pa tvsh

Po nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se operatori ekonomik “UNIVERS PROMOTION” SHPK, për përmbushjen të kriterit të mësipërm, ka paraqitur dokumentacionin Kontrata_te_ngjashme PDF në të cilën janë faturat e fiskalizuar si më poshtë vijon:

- Fature nr.2523/2024 me vlere 373 114.82 lekë pa tvsh
- Fature nr.3598/2024 me vlere 566 666.67 lekë pa tvsh
- Fature nr.300/2025 me vlere 292 046 lekë pa tvsh
- Fature nr.527/2025 me vlere 850 000 lekë pa tvsh
- Fature nr.898/2025 me vlere 268 000 lekë pa tvsh
- Fature nr.782/2025 me vlere 260 650 lekë pa tvsh
- Fature nr.1174/2025 me vlere 566 800 lekë pa tvsh
- Fature nr.1402/2025 me vlere 662 500 lekë pa tvsh
- Fature nr.1358/2025 me vlere 253 325 lekë pa tvsh
- Fature nr.1727/2025 me vlere 449 840 lekë pa tvsh
- Fature nr.1746/2025 me vlere 282 000 lekë pa tvsh

III.8.4. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: *Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

III.8.5. Në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se 1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe vepronë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

III.8.6. Në nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- d) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- e) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- f) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

III.8.7. Neni 41 “Kërkesa të vecanta për kontratat e shërbimeve”, të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

1. Në procedurat e prokurimit për shërbime, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë qartë në termat e referencës, natyrën, objektin, qëllimin, specifikimet teknike dhe afatet kohore të shërbimit që do të kryhet.

2. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

3. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara. Në rastin e procedurave të prokurimit “Shërbim konsulence”, si përvojë e mëparshme për shërbimet e ngjashme me objektin e prokurimit do të njihen dhe/ose shërbimet e ngjashme me fushat përkatëse të ekspertizës, pjesë e objektit të prokurimit.

4. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

d) Në rastin e procedurës së prokurimit “Shërbim konsulence”, stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.

5. Për të provuar se, operatori ekonomik vepron konform kërkesave të legjislacionit në fuqi, autoriteti/enti kontraktor kërkon që:

a) operatori ekonomik të ketë shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

b) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi.

c) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës.

ç) operatori ekonomik të paraqesë ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi.

6. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

7. Në rastin e prokurimit të kontratave shumëvjeçare, autoriteti/enti kontraktor duhet të hartojë kërkesat për kualifikim në përputhje me fondin total të përlllogaritur..

III.8.8. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kritereve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit.

III.8.9. Referuar sa më sipër, Komisioni konstaton, se në dokumentet e tenderit të procedurës objekt-ankimi, autoriteti kontraktor në lidhje me vërtetimin e përvojës së ngjashme ka kërkuar që operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duhet të paraqesin “furnizime të ngjashme me objektin e prokurimit në një vlerë jo më të vogël se 20 % fondit limit në një vlerë prej 558 790 (pesëqind e pesëdhjetë e tetë mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë) lekë, të ekzekutuar gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. KPP gjykon të ndalet në një analizë të thelluar të dëshmive të eksperiencës së ngjashme të dorëzuar nga ana e operatori ekonomik Aerd Mahmutaj, parë kjo në rrafshin krahasimor me kërkesat teknike të autoritetit kontraktor, natyrës së procedurës së prokurimit objekt-ankimi. Kështu, referuar shtojcës 7 të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar shërbimet objekt - prokurimi dhe sasinë respektive të tyre. KPP gjykon, se në rastin konkret, kërkesa e autoritetit kontraktor referuar objektit të procedurës së prokurimit, lidhet me Shërbime të printimit dhe publikimit.

Në nenin 77 pika 4 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” , i ndryshuar është parashikuar se: “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme

njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”. KPP vlerëson se së pari, norma juridike duhet të interpretohet e më pas të gjykohet, kjo për të analizuar në thelb *ratio legis*, kuptimin e drejtë të saj. Kështu, ligjvënësi ka parashikuar diskrecionin e autoritetit kontraktor të kërimit të dëshmimeve për përvojën e mëparshme, me synim për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Pra, e drejta e dhënë nga ligji lidhet ngushtësisht me garantimin e autoritetit kontraktor, se operatori ekonomik disponon dëshmi të përvojës së mëparshme për të realizuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Gjithashtu, me akt nënligjor, diskrecioni i vendosur nga ligji është rregulluar edhe më tej, ku në rastin e kontratave për mallra, ligjvënësi në nenin 40, pika 4 të Vendimit nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, ka parashikuar, se ky kriter në rastin e përvojës së ngjashme të mëparshme të realizuar me entet publike, mund të përmbushet me dorëzimin e vërtetimeve të lëshuara nga enti publik ose me paraqitjen e faturës tatimore të shitjes, ku vërtetohet realizimi me sukses i një ose disa kontratave të ngjashme gjatë tre viteve të fundit nga data e njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të madhe se 40 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe në rastin e përvojës së ngjashme të mëparshme të realizuar me sektorin privat mund të përmbushet me dorëzimin e faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe furnizimet e realizuara, ku të vërtetohet realizimi i furnizimeve të ngjashme gjatë tre viteve të fundit nga data e njoftimit të kontratës, me një vlerë jo më të madhe se 40 % e vlerës së kontratës që prokurohet. Gjithashtu, në rregullat e prokurimit publik është përcaktuar se plotësimi i njërit prej dy kushteve e bën ofertën të kualifikueshme.

Duke iu kthyer kriterit, KPP konstaton, se kriteri i hartuar nga ana e autoritetit kontraktor është në përputhje me diskrecionin e dhënë nga ligji dhe akti nënligjor, si edhe afati i kërimit të dokumentacionit është brenda periudhës trevjeçare sikundër parashikohet edhe në këtë Vendim të Këshillit të Ministrave.

Lidhur me faktin nëse dokumentacioni i dorëzuar nga operatori ekonomik “ALBDISAGN PSP” SHPK, dhe “UNIVERS PROMOTION” SHPK përmendur në pikën III.8.3. të këtij vendimi (Faturat Elektronike) plotësojnë apo jo kriterin kualifikues të furnizimeve të ngjashme, KPP do t’i analizojë në 3 (tre) komponentë kumulative dhe konkretisht komponenti i vlefshmërisë, komponenti i ngjashmërisë dhe komponenti i vlerës së realizuar. Për sa i përket vlefshmërisë së dokumentacionit të dorëzuar (Faturat Elektronike), Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se dokumentacioni është i vlefshëm për efekt të përmbushjes së kriterit kualifikues të sipërpërmendur dhe të përcaktuar në pikën 2.2.1 të dokumenteve të tenderit objekt-ankimi, pra është realizuar brenda afatit 3 (tre) vjeçar nga data e publikimit të njoftimit të kontratës (25.03.2026). Faturat elektronike janë të periudhës 2024-2026.

Lidhur me komponentin e ngjashmërisë, në analizë të thelluar dhe krahasimore të faturave tatimore të shitjes, të vlefshme, të dorëzuara nga ana e operatorëve ekonomikë “ALBDISAGN PSP” SHPK, dhe “UNIVERS PROMOTION” SHPK, KPP konstaton, se me anë të faturave tatimore të dorëzuara dëshmon, se ka kryer shërbime të natyrës së shërbimit objekt - prokurimi, sikurse është Shërbime te printimit dhe publikimit KPP konstaton, se nga shqyrtimi dhe verifikimi i të gjitha elementeve të këtyre faturave, rezulton, se këto fatura konsiderohen të ngjashme me objektin e prokurimit, pra operatori ekonomik ka arritur që të dorëzojë dëshmi që ka realizuar shërbime të ngjashme. Lidhur me komponentin e tretë, për sa i përket vlerës së faturave të paraqitura nga ana e operatorëve ekonomikë “ALBDISAGN PSP” SHPK, dhe “UNIVERS PROMOTION” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik vërtet se vlera e kërkuar në kriterin kualifikues është realizuar, madje më shumë se ajo e kërkuar, me faturat e paraqitura. Sa më sipër, KPP vlerëson, se faturat tatimore të dorëzuara nga operatorët ekonomikë “ALBDISAGN PSP” SHPK, dhe “UNIVERS PROMOTION” SHPK plotësojnë të tre komponentët kumulativ në interpretim të kriterit kualifikues. Në këtë kuptim, KPP gjykon, se operatorët ekonomikë “ALBDISAGN PSP” SHPK, dhe “UNIVERS PROMOTION” SHPK me dokumentacionin e paraqitur, provojnë se kanë kryer shërbime të ngjashme me objektin e prokurimit, duke plotësuar kështu kërkesën për kualifikim, për përvojë të suksesshme përcaktuar në pikën 2.1.1 të kriteve të veçanta të kualifikimit..

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “FILARA” SHPK nuk qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Inpress” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedure e hapur e thjeshtuar”, me REF-79675-03-19-2026, me objekt: “Shërbime të printimit dhe publikimit, materiale promociionale”, me fond limit 2 793 950 (dy milion e shtatëqind e nëntëdhjetë e tremijë e nëntëqind e pesëdhjetë) Lek pa TVSH, zhvilluar në datën 07.04.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Korçë.
2. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “FILARAs” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedure e hapur e thjeshtuar”, me REF-79675-03-19-2026, me

objekt: “Shërbime të printimit dhe publikimit, materiale promocionale”, me fond limit 2 793 950 (dy milion e shtatëqind e nëntëdhjetë e tremijë e nëntëqind e pesëdhjetë) Lek pa TVSH, zhvilluar në datën 07.04.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Korçë.

3. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
4. Ngarkohet zyra e financës, të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit, të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “ Inpress” SHPK.
5. Ngarkohet zyra e financës, të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit, të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “ FILARA” SHPK.
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

